



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.07.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.
(Komisioni përgjegjës)

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Ervis Meço, Edmond Stojku dhe Halil Jakimi.

Mungojnë:

Klotilda Bushka dhe Amra Barova

Të ftuar:

Ogerta Manastirliu – Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Merita Xhafaj - Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrëna - Drejtoreshë juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Etiola Kola - Këshilltare në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Eneida Capo - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Miranda Pashaj - Drejtoreshë e ndihmës ekonomike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi!

E hapim takimin e sotëm të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, i cili merr në shqyrtim projektligjin “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Nga komisioni përgjegjës kemi relatore Ardiana Jakun, e cila ka qenë dhe zëvendësministre.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë të pranishëm: Ogerta Manastirliu, ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Merita Xhafaj, drejtoreshë e Përgjithshme; Antoneta Njehrrëna, drejtoreshë juridike; Etiola Kola, këshilltare; Eneida Capo, përgjegjëse sektori, si dhe Miranda Pashaj, drejtoreshë e ndihmës ekonomike.

Sot kemi kalimin në parim të projektligjit.

Për këtë projektligj, që pritet t’i kalojë parlamentit në javët e ardhshme, do të dëgjojmë ministren e Shëndetësisë.

Fjala për ju.

Ogerta Manastirliu – Përshëndetje!

Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të bëj një paraqitje të shkurtër, një sintezë, të propozimit të qeverisë shqiptare për ligjin e ri “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, që vjen para Kuvendit të Shqipërisë për t’i konsoliduar më tej reformat e nisura, si reforma e ndihmës ekonomike, që tashmë është zbatuar në gjithë vendin dhe për t’i hapur rrugë reformave të reja për kategoritë në nevojë, siç janë personat me aftësi të kufizuara, si dhe konsolidimit të mëtejshëm të programeve të mbrojtjes sociale, siç është programi i bonusit të bebes.

Ligji “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” është hartuar duke pasur parasysh nevojat e individëve, të familjeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuara.

Ky ligj bazohet në parimet e solidaritetit, universalitetit, të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, mbështetjes, nëpërmjet mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të kategorive në nevojë, si dhe parashikon mënyrat dhe përfitimet, që do të kenë individët, familjet në nevojë apo personat me aftësi të kufizuara.

Ky ligj përcakton metodologji, mekanizma, por edhe funksione të ndara nëpërmjet të gjitha strukturave shtetërore, nga pushteti qendror te pushteti lokal, si në bashkitë dhe administratorët socialë të njësive administrative.

Ligji që paraqitet sot vjen në kuadër të reformave që kemi ndërmarrë ne duke i konsoliduar.

Dua të ndalem tek tri programet që parashikon ky ligj.

Programi i parë është ai ndihmës ekonomike. Ky program vjen pas një zbatimi prej 18 muajsh të reformës që ndërmorëm me ekspertizën e Bankës Botërore, në funksion të rishikimit të të gjithë skemës së ndihmës ekonomike.

Çfarë ndodhi 18 muaj më parë? Ne zbatuam atë që ishte pilotuar për 2 vjet në tri qarqe të vendit, në Tiranë, Elbasan dhe Durrës. U shtrimë në të gjithë Shqipërinë përgjatë këtyre 18 muajve dhe kjo solli rritjen mesatare të përfitimeve në *cash* për individët dhe familjet në nevojë. U hoqën të gjitha kriteret përjashtuese, pra arritëm që më shumë se 15 mijë familje, që nuk aplikonin për arsye të kriterëve përjashtuese, që ekzistonin në skemën e vjetër të ndihmës ekonomike, të mund të aplikonin. Gjithashtu, u ngrit një sistem i digjitalizuar pikëzimi për regjistrin e familjeve që aplikojnë, por edhe të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, nëpërmjet një sistemi pikëzimi të unifikuar, të punuar me mbështetjen dhe ekspertizën e Bankës Botërore, për të garantuar që skema e ndihmës ekonomike të mbështesë familjet më në vështirësi dhe të targetojë më mirë familjet e varfra, në mënyrë që të kemi një mbështetje direkte për ata që kanë më shumë nevojë.

Pas pilotimit, që u realizua në reformë, por edhe përgjatë muajve të implementimit të reformës, pamë se sa shumë ishin familjet apo individët që e përfitonin ndihmën ekonomike në mënyrë abuzive. Nuk ishin të pakta rastet e atyre që nuk përfituan më nga skema e ndihmës ekonomike, pikërisht në sajë të verifikimit *online*, që u realizua nëpërmjet kësaj reforme. Kjo reformë arriti të sjellë jo vetëm një sistem pikëzimi, jo vetëm një sistem digjital, por edhe një verifikim në kohë reale me 5 sisteme të reja të shtetit, nga gjendja civile deri te regjistrimi i automjeteve dhe hipoteka, që na jepnin një panoramë të qartë të situatës sociale dhe ekonomike të familjes që aplikonte për ndihmë ekonomike. Nuk ishin pak, por mbi 15 mijë raste, që përfitonin në mënyrë abuzive ndihmë ekonomike, sepse nëpërmjet sistemit të vjetër nuk arrihej të verifikohej nëse këto familje ishin të punësuar, sepse nuk ekzistonte sistemi *online* i verifikimit në kohë reale. Prandaj, në periudha të caktuara krijoheshin këto abuzivitete, të cilat u shmangën tërësisht me futjen e sistemit dixhital në kuadër të reformës së ndihmës ekonomike, e cila shmangu dhe nuk lejoi ndihmën e pjesshme, e cila jepej nga shumë bashki dhe nuk arrinte të mbështeste familjet në kesh, por duke i dhënë nga 10 mijë lekë të vjetër deri në 14 mijë lekë të vjetër një familjeje, bashki të caktuara i jepnin për favore politike dhe jo për të mbështetur familjet në nevojë, ndaj një herë e përgjithmonë u hoq ndihma e pjesshme, u vendos ndihma e plotë për çdo familje duke rritur mesataren e ndihmës ekonomike deri në 54 mijë

lekë të vjetër. Tavanit i ndihmës pa kompensime ishte 80 mijë lekë dhe propozimet që ne sjellim nëpërmjet ligjit të ri janë propozime që shkojnë në favor të konsolidimit të skemës së mbrojtjes sociale, që do të thotë edhe në favor të konsolidimit të reformës që ne kemi ndërmarrë për ndihmën ekonomike.

Ligji i ri parashikon disa përmirësime që kanë ardhur edhe në vijim të të gjitha problematikave që kanë dalë nga zbatimi i reformës, së pari, heqja e tavanit që parashikohej në ligjin e vjetër të 80 mijë lekëve. Heqja e këtij tavanit do t'i krijojë mundësinë qoftë Ministrisë së Shëndetësisë, qoftë qeverisë shqiptare të rishikojë masën e mbulimit të ndihmës ekonomike, kjo sigurisht në një plan afatmesëm dhe të lejojë familjet me shumë anëtarë të tejkalojnë një tavan, i cili, duke u vendosur në ligj nuk lejon që familjet me mbi 6 anëtarë të mund të përfitojnë përtej këtij tavanit të vendosur në ligj. Pra, heqja e këtij tavanit do të ndihmojë më shumë individë dhe familje, të cilat përfshihen në këtë skemë.

Së dyti, jo të gjithë personat në nevojë në bashki të ndryshme të vendit e merrnin ndihmën ekonomike atëherë kur parashikohej me ligj. Pse? Sepse këshillat bashkiakë kanë qenë organe, të cilat kalonin në parim listën e përfituesve nga programi i ndihmës ekonomike. Në të gjitha bashkitë mbledheshin këshillat bashkiakë dhe jo në të gjitha bashkitë kalonin në datën 20 të muajit pikërisht listat e përpunuara, sa i përket programit të ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar dhe kjo bënte që personat në nevojë dhe familjet në nevojë të mos i merrnin pagesat në kohën e duhur një herë në muaj. Kjo për arsye të mosmbledhjes së këshillave bashkiakë. Ndaj në ligjin që propozojmë këtë detyrë dhe këtë kompetencë që më parë e kishin këshillat bashkiakë ua kalojmë drejtorive të shërbimit social shtetëror në qarqe duke krijuar një mundësi më të shpejtë për dhënien e kësaj ndihme dhe duke ulur burokracinë, sepse bëhet në mënyrë dixhitale, automatike, ndërsa këshillave bashkiakë i ngarkohet kompetenca për të vendosur kriteret për të përdorur pikërisht fondin 6% që i alokohet nga Ministria e Shëndetësisë çdo bashkie për vendosjen e kriterëve, në mënyrë që ata individë ose familje që nuk kanë përfituar nga sistemi i pikëzimit, por janë në vështirësi sociale dhe ekonomike të mundën që me kriteret e bashkive të marrin ndihmën. Pra, fondi 6% është për ata individë dhe familje që do të përfitojnë nga kriteret që vendosin këshillat bashkiakë.

Gjithashtu, një ndër risitë e ligjit është kufizimi kohor në qëndrimin e skemës së ndihmës ekonomike. Është një ndër objektivat tanë që ndihma ekonomike, programet e mbrojtjes sociale t'i jepen dhe të mbështesin ato individë ose familje në nevojë, të cilat në një moment të caktuar të jetës kanë nevojë të mbështeten nga shteti, por ne nuk mund të mbështesim pasivitetin ndaj programet e integruara të mbrojtjes sociale, me përfshirjen sociale, me programet e punësimit dhe edukimit në vazhdim për anëtarët në moshë madhore brenda

familjeve që marrin ndihmën ekonomike, por që kanë mundësi të punësohen, të jenë pjesë e skemave të trajnimeve profesionale dhe të punësimit në mënyrë që mbështetja me ndihmë ekonomike t’iu jepet atyre familjeve që kanë më shumë nevojë për një periudhë të caktuar dhe pas kësaj periudhe të jemi po ne që t’i mbështesim nëpërmjet punësimit të qëndrueshëm që do të sjellë integrimin e këtyre familjeve në shoqëri. Ky ligj parashikon krijimin e strategjive të daljes nga skema e ndihmës ekonomike nëpërmjet punësimit.

Një paketë të plotë për metodologjinë dhe mekanizmat koordinues ose udhërrëfyesish ose protokollesh janë parashikuar për t’u hartuar nga ministria dhe institucionet përgjegjëse, të cilët parashikojnë adresimin e çdo qytetari përfitues të ndihmës ekonomike drejt punësimit të qëndrueshëm.

Për fëmijët dhe fëmijëve që ndjekin arsimin e mesëm ose të lartë ne kemi parashikuar përjashtimin nga detyrimi i paraqitjes pranë zyrave të punës për të kërkuar punë gjatë kohës që ata janë studentë, që familja të mos penalizohet për përfitimin e ndihmës ekonomike. Është një ndër kërkesat që edhe grupet e interesit na kanë paraqitur, organizatë jofitimprurëse, por gjithashtu është edhe një mbështetje që ne duam të garantojmë për të gjithë ato familje në nevojë, duke lehtësuar qëndrimin e tyre në skemë deri në momentin që fëmijët e tyre përfundojnë ciklin e edukimit.

Gjithashtu, propozojmë ta kemi në ligj tërheqjen e ndihmës ekonomike nga bashkëshortet. E kemi të përcaktuar sot në vendimin e Këshillit të Ministrave, propozojmë ta fusim në ligj që ndihma ekonomike të tërhiqet nga bashkëshortet. Në rastet kur nëna ose gruaja nuk është brenda certifikatës familjare të familjes, që përfiton asistencën, do të tërhiqet nga kryefamiljari.

Projektligji parashikon edhe rastet që përjashtohen nga skema e ndihmës ekonomike, si afatet e përjashtimit dhe të drejtën për riaplikim dhe përfitim, të cilat variojnë nga 6 muaj deri në 1 vit. Në rastet e përjashtimit nga skema e ndihmës ekonomike pa të drejtë riaplikimi për një periudhë 6 mujore përfshihen ato familje, të cilat kryejnë ndarje të qëllimshme nga trangu familjar, nuk e tërheqin ndihmën ekonomike për një periudhë kohore, pra tregojnë që familja nuk jeton në sate të ndihmës ekonomike, por ka të ardhura të tjera që i ka pasur të padeklaruara, sigurisht këto pas verifikimeve që realizon administratori shoqëror në njësine administrative ose bashkinë ku është përfitues, refuzon verifikimin e situatës socio-ekonomike në familje ose kryen deklaratime të rreme dhe nuk kërkon punë ose refuzon përfshirjen në kurset e arsimit profesional për familjet që refuzojnë ofertat e përshtatshme për punë në zyrat e punës, që punësohen dhe ndërpresin marrëdhëniet e punës pa shkaqe të arsyeshme, që kanë kryer më shumë se një deklaratim të rremë apo kur rezultojnë me të ardhura dhe kushte shumë të mira

sociale dhe ekonomike, përjashtimi nga skema e ndihmës ekonomike pa të drejtë riaplikimi parashikohet të jetë për një periudhë 1-vjeçare.

Ne kemi vendosur t'i përcaktojmë këto raste në ligj, sepse duam të parandalojmë deklaratimet e rreme, të cilat sot sigurisht me sistemin tonë elektronik digjital janë shumë më të lehta për t'u verifikuar, pasi sistemet verifikojnë njëra-tjetrën, po ashtu është edhe punonjësi social pranë Drejtorive të Shërbimit Social Shtetëror Rajonal, i cili i kryen këto verifikime *online*, por janë edhe verifikimet periodike, të cilat i kryejnë administratorët socialë që na japin të dhëna indikative për familjet përfituese edhe kur përfitojnë nga sistemi i pikëzimit.

Pra, kjo skemë që ne kemi propozuar dhe që po e implementojmë është një instrument, i cili kërkon vërtetësi. Sidomos ata që aplikojnë dhe deklarojnë të vërtetën sistemi duhet t'i përfshijë. Në rastet kur refuzohet punësimi, arsimi profesional apo kur deklarohet në mënyrë të rreme, sigurisht që sistemi do t'i penalizojë. Patjetër që familja mund të mbështetet në një nga programet sociale, por jo nëpërmjet asistencës ekonomike.

Një ndër elementet që dua të theksoj këtu është edhe sistemi i konsoliduar digjital i ndihmës ekonomike, ku procedura e aplikimit kryhet pranë administratorit shoqëror të njësive administrative nëpërmjet përdorimit të Regjistrat Elektronik Kombëtar, i cili garanton më shumë transparencë, eficiencë të procesit nga aplikimi te vendimmarrja. Pra, që në fillim të procesit ne garantojmë transparencë për ata që aplikojnë në këtë skemë, por deri në përfundim të procesit ky sistem garantohej dhe monitorohet nëpërmjet sistemit elektronik të digjitalizuar. Projektligji që ne po paraqesim para jush do të përcaktojë edhe transparencën e formulës së unifikuar të pikëzimit, i cili do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Aktualisht ne kemi një sistem të unifikuar të pikëzimit, i hartuar me mbështetjen e ekspertëve të Bankës Botërore, i cili praktikisht përcakton mënyrën dhe koeficientët, të cilat më pas përkthehen sipas koeficienteve në një sistem mbledhës pikësh për familjet apo individët aplikues në skemë, por sigurisht parashikohet që ky sistem me ndryshimet që mund të ndodhin, si dhe me përfshirjen nëpër qarqe apo njësi administrative situata socio-ekonomike mund të ndryshojë. Sistemi i unifikuar i pikëzimit pas konsultimeve mund të jetë subjekt i ndryshimeve në një moment tjetër, ndaj ne kemi vendosur që ky sistem të jetë pjesë e paketës së transparencës, e cila do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Projektligji përveç skemës së ndihmës ekonomike parashikon edhe skemën e pagesave në kesh për aftësinë e kufizuar. Skema e pagesave në kesh për aftësinë e kufizuar është një ndër reformat, që tashmë është iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e ekspertëve të Bankës Botërore. Aktualisht jemi në pilotimin e dy njësive administrative në Tiranë dhe brenda këtij viti do ta shtrijmë skemën e re të vlerësimit

biopsikosocial për personat me aftësi të kufizuar në të gjitha njësitë administrative të Tiranës. Sfida e radhës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale është pikërisht aplikimi i kësaj metodologjie të re nëpërmjet standardeve të reja të klasifikimit të sëmundjeve, të cilat janë pilotuar dhe tashmë do të shtrihen në të gjithë Tiranën dhe pikërisht miratimi i këtij ligji do t'i hapë rrugën edhe vijimit të kësaj reforme, e cila është një reformë që praktikisht do të na sjellë një konsolidim shumë më të mirë të mbështetjes së personave me aftësi të kufizuar, të cilët mund të lindin apo të bëhen të tillë gjatë jetës së tyre, por mbështetja për ta do të jetë shumë më e targetuar në bazë të rëndësës që ata kanë sa i përket statusit të tyre biopsikosocial.

Pra, nuk do të ketë vetëm një vlerësim sa i takon sëmundjes, kur flasim për vlerësimin e mbështetjes së pagesave të aftësisë së kufizuar, por edhe të statusit social të familjes dhe të rëndësës që vetë personi ka në kuadër të atyre problematikave me shëndetin për personat me aftësi të kufizuar, paraplegjikë, tetraplegjikë, të verbër apo klasifikime të tjera sipas statusit.

Është e rëndësishme për t'u theksuar që në gjithë këtë reformë jemi bazuar në Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, ligjin për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar, në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe klasifikimin ndërkombëtar të funksioneve. Sigurisht, një ndër arsyt kryesore të reformës që ne kemi ndërmarrë për aftësinë e kufizuar është reflektimi i praktikës bashkëkohore ndërkombëtare të shndërrimit të vlerësimit mjekësor në vlerësimin biopsikosocial, rritjen e eficiencës së vlerësimit, duke krijuar mekanizma administrativë që reduktojnë ndjeshëm shkallën e abuzimit dhe rrisin besueshmërinë dhe koston e vlerësimit, përmirësimin e shërbimit për qytetarët, uljen e burokracive, që është një ndër elementet e tjerë që na ka drejtuar drejt kësaj reforme.

Një ndër elementet, i cili pas vlerësimit të dy njësive administrative dhe pilotimit, ka vlerësuar se kjo skemë ka një përqindje abuziviteti brenda saj. Një paketë trajnuese për të gjitha komisionet e caktimit të aftësisë për punë është hartuar nga kjo reformë dhe është mëse objektive arsyeja pse ne e kemi ndërmarrë këtë reformë, pasi abuziviteti që u konstatua në programin e ndihmës ekonomike është njësoj edhe në programin e aftësisë së kufizuar.

Pra, e gjithë kjo ka ndodhur se nuk janë përcaktuar në detaje të gjithë ato elemente që përcaktojnë aftësinë e kufizuar, ndërkohë nuk ka edhe një përshkallëzim të aftësisë së individit kur bëhet fjalë për mbulimin financiar të tij me programe të asistencës sociale. Sigurisht, ai që ka më shumë vështirësi duhet të mbështetet më shumë financiarisht dhe të përfitojë edhe ndihmësin personal. Ndihmësi personal është një ndër përkufizimet e reja që është shtuar në këtë ligj, i cili deri më sot është quajtur “kujdestari” dhe tani e tutje do të quhet “ndihmësi personal”. Reforma ka përcaktuar se kush quhet ndihmësi personal dhe se si do të trajtohet ky

ndihmës, si dhe për çfarë klasifikim sëmundjesh do të ketë mundësi një person me aftësi të kufizuar të ketë ndihmës personal.

Kjo është një sfidë me të cilën do të përballen të gjithë, edhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, pasi është pikërisht ajo që e ka iniciuar dhe do ta aplikojë deri në fund këtë reformë, e cila në të gjitha hapat e saj do të jetë e konsultuar me grupet e interesit, me shoqatat që përfaqësojnë këto grupe të aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, dua t'ju them se ky ligj është konsultuar me të gjithë grupet e interesit përgjatë gjithë fazave të hartimit të tij në mënyrë që ne të kemi sa më shumë komente dhe sugjerime nga këto grupe dhe të sjellim te ju draftin më të mirë të një ligji, i cili është i aplikueshëm në radhë të parë, një ligj që i përgjigjet kontekstit dhe të gjitha atyre elementeve që përbëjnë thelbin e punës sonë, që është mbështetja e të gjithë atyre që kanë më shumë nevojë, pra e personave me aftësi të kufizuar, si dhe një graduatore, e cila është mëse e nevojshme për personat me aftësi të kufizuar. Jo të gjithë këta persona duhet të trajtohen njësoj, por të gjithë duhet të marrin një ndihmë për t'u riintegruar në shoqëri.

Në këtë projektligj përcaktohet se e drejta e përfitimit të përcaktimit të pagesës së aftësisë së kufizuar i mbetet personit me aftësi të kufizuar edhe kur ai përfshihet në skemën e punësimit për një periudhë 4-vjeçare. Ne kemi vlerësuar që duhet të mbështetet për 4 vjet, sigurisht, për të siguruar punësimin e qëndrueshëm edhe me skemën ekzistuese, por më e rëndësishme është se nuk i hiqet e drejta të riaplikojë në rastet kur del nga skema e punësimit. Gjithashtu, projektligji parashikon që pagesat, që jepen për ndihmën e menjëhershme financiare, të kenë edhe lehtësira për sa i përket dhënies së pagesave, të cilat nuk do të kalojnë më nga këshillat bashkiakë, por do të jenë direkt një vendimmarrje e drejtorive të shërbimit social shtetëror, ku edhe drejtoritë e shërbimeve sociale në bashki do të kenë rolin e tyre për hartimin e këtyre listave dhe dërgimit të projeksioneve periodike te drejtoritë e shërbimeve sociale shtetërore për livrimin e fondeve.

Për sa i përket programit të tretë që ligji “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” përfshin, është bonusi i bebes apo shpërblimi financiar për foshnjat e porsalindura. Kjo është konceptuar si një paketë e plotë, duke parashikuar, gjithashtu, edhe garantimin e fondeve. Kjo skemë ka 6 muaj që është implementuar dhe nga fillimi i buxhetimit të kësaj skeme, në datën 1 janar e deri tani, ka rezultuar e suksesshme. Deri në muajin qershor kanë lindur më shumë se 12 mijë bebe. Familjet e këtyre bebeve kanë përfutur nga programi i bonusit të bebes: për fëmijën e parë 400 mijë lekë, për fëmijën e dytë 800 mijë lekë, për fëmijën e tretë 1 milion e 200 mijë lekë e kështu për fëmijën e katërt, të pestë, që do të thotë se është një mbështetje më shumë për familjet e reja, një start i barabartë i vendosur për të gjithë fëmijët

dhe familjet e tyre. Sigurisht, është edhe një mbështetje apo politikë për sa u përket politikave pronataliste për të rritur lindshmërinë, duke qenë se Shqipëria, ashtu si edhe të gjitha vendet europiane, po përballlet me një ulje të lindshmërisë. Pikërisht qeveria i ka bërë këto politika për këto arsye dhe vendosja e këtij programi në ligj e bën shumë më të qëndrueshëm atë dhe u jep mundësi familjeve të përfitojnë nga ky program, por, gjithashtu, të kenë mundësinë e alokimit si një asistencë, si një shpërblim financiar, brenda programeve të asistencës sociale që ne sjellim këtu për miratim.

Kjo ishte një përmbledhje e tri programeve, që parashikon pikërisht ligji i ri që ne kemi sjellë për miratim “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Unë ju ftoj që ta miratojmë në parim këtë projektligj dhe jam e hapur nëse do të keni pyetje.

Faleminderit!

Enver Roshi - Faleminderit, zonja Ministre!

Debati është i hapur, ndaj ftoj deputetët të bëjnë pyetje rreth raportit që paraqiti ministrja lidhur me këtë projektligj. Si fillim, po ngre unë disa pyetje dhe më pas do t’ua jap fjalën kolegëve të tjerë.

Në lidhje me sistemin e pikëzimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, po e ndërpres fjalën time dhe po ia jap fjalën relatores.

Ardiana Jaku – Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit, zonja Ministre, për të gjithë paraqitjen shteruese të ligjit!

Ky ligj, që vjen sot para nesh, është hartuar dhe është rregulluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ky projektligj ka për qëllim të rregullojë mënyrën e dhënies së ndihmës ekonomike, të pagesave të aftësisë së kufizuar dhe bonusit të bebeve për të garantuar mbrojtje sociale për të gjithë qytetarët.

Shumë shkurt do të paraqes tri programet, ku duhet të përqendrohemi për ta kaluar sa më parë në parlament këtë projektligj.

Projektligji specifikon që ndihma ekonomike do të përfitohet nga familjet pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme nga programet e tjera të mbrojtjes shoqërore, si: remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhurat e tjera. Nëpërmjet këtij projektligji thjeshtohen procedurat për përfitimin e ndihmës ekonomike, duke përcaktuar procese të qarta dhe efiente të aktorëve të përfshirë në administrimin e skemës. Në këtë projektligj, nxitur edhe nga komentet e ndryshme të grupeve të interesit, aneksohet roli i këshillit bashkiak, i cili, në të

shumtën e rasteve i ka penalizuar vazhdimisht qytetarët për mosmarrjen në kohë të përfitimit të ndihmës ekonomike.

Një problematikë, që evidentohet në skemën aktuale, ka të bëjë me shmangien e përfituesve të ndihmës ekonomike, të cilët janë në moshë aktive pune dhe mospërfshirjen e tyre në programet e formimit profesional apo aftësimin për punë. Në këtë kuadër, kufizimi kohor i përfitimit të ndihmës ekonomike, që sjell ky projektligj, do të synojë integrimin në jetën shoqërore të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike, duke i nxitur qytetarët të përfshihen në programet e formimit profesional për të marrë një profesion, në përfshirjen në programe të këshillimit për punësim dhe, më kryesorja, në punësimin e tyre nëpërmjet ofertave të punës, që disponojnë zyrat e punës.

Programi tjetër, i cili, në fakt, është edhe një problematikë e hasur vazhdimisht edhe nga qytetarët, që ndodhen në zonat që ne përfaqësojmë, është edhe procesi aktual i vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Aktualisht është një proces i gjatë, i komplikuar, i ndryshëm për aftësi të kufizuara të ndryshme. Sistemi aktual bazohet tërësisht në kritere mjekësore dhe nuk merr në konsideratë aftësinë e individit për të realizuar aktivitete të jetës së përditshme.

Ministria bëri një paraqitje shteruese të synimeve që ministria ka për reformimin e të gjithë kësaj skeme, kështu që edhe në këtë projektligj ministria ka përcaktuar thjeshtimin e procedurave të panevojshme për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar, pra heqjen e vendimmarrjes nga këshilli bashkiak, si dhe dhënien e këtij përfitimi bazuar në vendimin e autoritetit përgjegjës për përcaktimin e kësaj të drejtë, që është Komisioni Mjekësor i Vlerësimit të Aftësisë për Punë.

Gjithashtu, programi i tretë, që na vjen për shqyrtim në këtë projektligj, është ndihma e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura apo e njohur ndryshe si bonusi i bebes. Kjo është një politikë e re sociale prolindshmërisë, duke e shumëfishuar masën financiare për numrin e fëmijëve të lindur.

Nga një vështrim, që i është bërë projektligjit të propozuar, vërehet se efektet financiare të tij do të jenë: fondi i pagesave të ndihmës ekonomike, fondi i pagesave të aftësisë së kufizuar, por, gjithashtu, vlen të përmendet edhe pagesa shtesë për vaksinimin, ndjekjen e arsimimit të detyrueshëm për fëmijët e familjeve përfituese. Burimi i financimit është buxheti që i është miratuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për programin buxhetor për kujdesin social.

Efektet e pritshme të projektligjit janë: rritja e eficiencës dhe barazisë në skemën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar; targetimi më i mirë dhe mbulimi më i gjerë i

familjeve dhe individëve në nevojë; rritja e numrit të lindjeve dhe mbështetja e familjeve me foshnja të porsalindura.

Pas gjithë kësaj përmbledhjeje, ftoj të gjithë kolegët që ta mbështesim këtë projektligj, i cili synon një targetim më të mirë të individëve dhe të familjeve në nevojë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zonja Adriana për relacionin e paraqitur dhe për mbrojtjen që i bëtë ligjit!

Unë, personalisht, nisur edhe nga eksperiencia që kam, e vlerësoj ligjin si pozitiv në disa pika, veçanërisht në heqjen e rolit të këshillave bashkiakë, pas vlerësimit të kritereve që ai bën për dhënien e ndihmës ekonomike. Kjo bëhet edhe për eksperiencën negative që kemi pasur, ku, shpeshherë, në këshillat bashkiake njëra forcë politike ka ikur dhe ka bllokuar dhënien e ndihmës ekonomike, por aspekti më negativ ka qenë presioni që u është bërë qytetarëve vazhdimisht në zgjedhje për heqjen e ndihmës ekonomike. Pra, ka qenë një presion shumë negativ, ku ka pasur qytetarë të fiksuar për marrjen e ndihmës ekonomike, në mënyrë që më pas të jepnin votën e tyre. Një situatë e tillë nuk duhet të ndodhë më.

Gjithashtu, unë vlerësoj edhe heqjen e tavanit që pasqyrohet në këtë ligj, pra që nuk ka më tavan, si dhe llogaritjen e ndihmës ekonomike në bazë të numrit të pjesëtarëve të familjes, gjë që e ndihmon shumë familjen në vetvete. Ajo që dua të theksoj ka të bëjë me sistemin e pikëzimit. Si është ndarë ky pikëzim i parë, sepse mund të kesh sëmundje, që është pikëzim kryesor, por ka disa elemente të tjera që ai të mos e bllokojë atë pikëzim... Për shembull, prania e televizorit të prishur, ndërkohë që është i sëmurë ose i papunë, nuk e merr atë për shkak të disa pikëve shtesë. Cila gjë e përbën fondin kryesor të pikëve, pra për domosdoshmërinë e marrjes së KEMP-it? Pra, të mos pengohet nga disa pikëzime të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po në rast se një tetraplegjik ndodhet në një zonë malore të theksuar, i cili nuk arrin dot të shkojë te Komisioni Mjeko-Ligjor, a është e mundur që ky i fundit të shkojë tek i sëmuri për t'i ardhur në ndihmë qytetarit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto ishin disa nga pyetjet e mia.

Këtu ka shumë pyetje në lidhje me ligjin, sepse ligji është shumë i gjerë. Ndoshta në një mbledhje të tillë është edhe paaftësia jonë për ta digjestuar ligjin, por besoj se të gjithë deputetët e këtij komisioni e kanë parë ligjin. Nëse jo, kanë kohën e nevojshme për ta parë ligjin në takimin e ardhshëm, që do të kemi për ta diskutuar edhe me grupet e interesit, natyrisht

ka elemente që duhen parë për ta përmirësuar ligjin, duke e çuar atje ku duhet dhe ku i nevojitet qytetarit.

Lidhur me aftësimin profesional, për zonat urbane është i arrirë. Po për zonat rurale çfarë mendohet, për shembull, për arsimin profesional? A ka ndonjë strategji të tillë në këtë aspekt?

Një element tjetër është roli i administratorit, që është shumë kyç në këtë aspekt. Do të desha që këtë rol ta zhveshim nga ana politike dhe t'ia lëmë aspektit qytetar të ndihmës sociale, që ai të jetë vërtet një shërbyes i qytetarëve. Nuk e di se si kjo mund të arrihet, është pak e vështirë në kontekstin shqiptar, por besoj që në monitorimin e tij ai ta realizojë punën siç duhet. Çfarë profili kanë këta administratorë socialë, të cilët merren me vlerësimin dhe monitorimin e këtyre rasteve? Pra, të jetë një person tamam social, të mos jetë politik dhe të bëjë një punë sociale, pra ta ushtrojë profesionin e tij në ndihmë të qytetarëve.

Natyrisht, edhe kufizimi kohor, në qoftë se ai nuk paraqitet për ta marrë ndihmën ekonomike, madje u bëj thirrje të gjithë njerëzve, që merren me këtë punë, që ta përdorin këtë në kontekstin më të mirë të fjalës, sepse njerëzit kanë edhe probleme, si, për shembull, s'mund të shkojnë, të shikohet rast pas rasti, jo të merret si shabllon që, pse nuk ke qenë atje të tërheqësh ndihmën ekonomike, unë ta heq ndihmën ekonomike, por të shikohet pak në kontekstin më social, për të qenë më afër qytetarit. Për shembull, mund të jetë një i sëmurë në qytet ose gjetkë, i cili nuk arrin ta marrë ndihmën ekonomike. Për shkak të angazhimit që ka, ai nuk mund të shkojë atje. Pra, duhen parë më afër gjërat.

Disa elemente që vijnë si risi në ligjin tonë: monitorimi, dixhitalizimi, pikëzimi dhe heqja e tavanit. Por unë dua të bëj një pyetje: cili është minimumi jetik në Shqipëri? A është përcaktuar nga ministria sa është minimumi jetik i një familjeje në Shqipëri?

Kam dëgjuar nga shumë ekspertë për projektin pilot, që bëhet në Tiranë për vlerësimin e ndihmës ekonomike, se është me kosto shumë më të lartë sesa aktualisht. A është vlerësuar kostoja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di, por kjo mbetet për t'u parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto ishin disa nga pyetjet e mia për momentin. Ndoshta mund të kem pyetje të tjera më vonë, por ftoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj ta organizojmë mbledhjen në këtë mënyrë: të bëhen pyetjet nga të gjithë kolegët dhe pastaj ju mund të përgjigjeni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni mbledhje lart?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kush ka pyetje, le t'i bëjë shkurt dhe pastaj të qëndrojë dikush nga ministria për përgjigjet.

Po, Visi.

Ervis Meço – E falënderoj zonjën ministre për të gjithë pasqyrimin që i bëri kësaj reforme të thellë dhe sensitive, për vetë faktin sepse nuk është sfidë vetëm e shoqërisë sonë shqiptare. Shtresat e marginalizuara janë sfidë dhe problematikë me një sfond karakteristik për çdo qeveri në Ballkan, në Europë ose në botë.

Ajo çka unë vura re, dhe jam në unison me ministren, është ideja që ne të gjithë si mekanizma, si shoqëri, si aktorë kryesorë duhet të bashkëpunojmë për të dënuar moralisht në të gjitha format pasivitetin dhe abuzimet e bëra.

Jam shumë dakord me të gjithë progresin e bërë nga projekti pilot i pikëzimit, ku gati mbi 30 mijë familje, që kanë qenë pa kritere dhe përfitonin ndihmën ekonomike, tashmë në këtë sistem të mirëmenduar dhe të menaxhuar nuk e përfitojnë më.

Unë kam vetëm një pyetje sensitive, e cila në përmbajtje është në unison me ministren, pa dashur të krijoj mbivendosje. Absolutisht, në çdo temë që ka të bëjë me çështjet e marginalizuara, kryesisht po themi me komunitetin rom dhe egjiptian të Shqipërisë, vërej, dhe dua ta ngre si shqetësim sot se si mund të progresohemi më vonë, se krijohet vetëm ideja e një “progresi” në nivel punësimi profesional. Për shembull, në fjalën e ministres vura re se ajo tha që, përveç anës juridike dhe mbledhjes së të gjithë informacionit online në të gjithë përpjekjen e shkollave profesionale dhe zyrave të punës duhet të jemi në unison për t'i integruar këto grupe shoqërore.

Shqetësimi im është ky që, duke qenë se është një nga pesë kriteret kryesore, që duhet të përmbushë kjo qeveri për çeljen e negociatave, pyetja ime është e drejtpërdrejtë (ku, përtej nivelit të mëshirës, të lëmoshës, në *database*-in tim, si njohës i mirë i të dyja minoriteteve, në pesë vjet kam 1200 studentë me arsim të lartë): duke filluar nga ministria juaj, zonja Ministre, që nga niveli i rojës së parkimit deri te zëvendësministri, sa të punësuar ka, si proces i integritetit të këtyre dy shtresave të marginalizuara?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mos e mbajmë diskutimin thjesht te lëmosha, tek arsimi profesional, pasi ka 1200 studentë që i njoh drejtpërdrejt, që janë diplomuar. Pra, pyetja ime është: a ka një plan konkret punësimi për këta njerëz? Sepse ne folëm thjesht që hajde t'i “dënojmë” të gjithë njerëzit që

abuzojnë dhe t'i ndihmojmë të dalin nga skema ekonomike për t'i çuar drejt arsimit profesional. Kjo është një gjë shumë e mirë. Tani, këta qindra, mijëra studentë, të cilët unë i kam njohur në praktikat e mia nga Delvina deri në Dibër, të cilët vijnë nga familje të varfra, çfarë kanë bërë? Kanë bërë pikërisht atë që tha zonja ministre: prindërit e tyre, me atë gjendje ekonomike që kanë pasur, nuk kanë dashur që t'i lënë të paintegruar, i kanë çuar të ndjekin arsimin e lartë për të kapur ritmin e shoqërisë. Atëherë, cili është modeli i qeverisë që japim për këta njerëz?

Pyetja është sa shabllone, aq edhe sensitive: përse u shërben diploma këtyre njerëzve? A ka kuptim diploma e tyre sot në vitin 2019? Sepse ne çfarë progresojmë në të gjitha drejtimet?! Të dalim nga skema ekonomike, të dalim nga gjendja e informalitetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetja ime, edhe një herë, është: cili është programi real që ministria ka për këtë nivel?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Faleminderit, Visi!

Atëherë, unë kërkoj ndërprerjen e mbledhjes së komisionit, për shkak të një angazhimi që ka grupi i maxhorancës parlamentare, për t'u kthyer përsëri në mbledhje për përgjigjet e pyetjeve.

(15 minuta pushim)

Enver Roshi - Vazhdojmë me seancën e pyetjeve. Unë kam disa pyetje që bëjnë shumë invalidë. Në nenin 8, ku thuhet: “Invalidët e punës që me vendim të komisionit kanë humbur aftësinë për punë, por që nuk përfitojnë pension invaliditeti nga sigurimet shoqërore, për mosplotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në ligjin “Për sigurime shoqërore” trajtohen pa pagesë, kur në 5 vjetët e fundit nuk kanë 1 vit sigurime shoqërore”, si do të rregullohet ky problem? Është një shqetësim shumë serioz, sepse ka një shtrirje në të gjithë Shqipërinë, mbulon një numër të madh njerëzish, sidomos gratë, që nuk kanë pasur mundësi të punojnë dhe vuajnë nga sëmundje tumorale, pra nuk kanë aftësi. Si do t'u vijmë në ndihmë këtyre personave? Ka pyetje të tjera për projektligjin nga anëtarët e komisionit?

Grupet e interesit do të bëjnë pyetje, ju do të dëgjoni, nuk do të hyjmë fare në debate. Ata i kanë depozituar mendimet e tyre. Nuk dua të futemi në debate me grupet e interesit, kjo për shkak të kohës, apo jo?

Ogerta Manastirliu - Faleminderit, zoti kryetar!

Për të ezauruar pjesën e parë të pyetjeve që nuk arritëm t'u kthenim përgjigje për shkak të shkëputjes, po u përgjigjem pyetjeve tuaja. Po ndalem te pyetja e fundit dhe më pas do të kaloj në të gjitha pyetjet.

Për sa i përket shqetësimit që ngritët në kuadër të mbështetjes financiare të personave të cilët 1 vit në 5 vjetët e fundit, nuk kanë punuar dhe si rrjedhojë nuk përfitojnë nga pagesa e aftësisë së kufizuar, dua t'ju informoj se kjo dispozitë nuk parashikohet në projektligj, pasi është një dispozitë që i përket ligjit “Për sigurimet shoqërore”. Në vitin 2014 është marrë ky vendim dhe tashmë është në vlerësimin e Ministrisë së Financave dhe nuk bën pjesë të mbrojtja apo asistencë sociale që parashikohet në këtë projekt. Kjo është një kategori, e cila duhet të mbështetet, pasi invalidizohet në 5 vjetët e fundit, ku 1 vit nuk ka qenë në punë. Ne kemi ngritur një grup pune të përbashkët me Ministrinë e Financave, me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, me Shërbimin Social Shtetëror, ministria jonë gjithashtu dhe jemi duke vlerësuar këtë kategori, mënyrën sesi do të mbështetet në vijim, pavarësisht faktit se përcaktimi ligjor për sa i përket mbështetjes së kësaj kategorie ka qenë në dispozitat e ligjit “Për sigurimet shoqërore” dhe jo në ligjin “Për asistencën sociale”. Dua t'ju informoj se për kategorinë e invalidit të punës, siç është kjo kategori, në reformën tonë për aftësinë e kufizuar, ky është një grup, që konsiderohet prej rreth 3 mijë qytetarësh. Jemi duke vlerësuar mënyrën se si ata mund të mbështeten për shkak të aftësisë së kufizuar që ata mund të kenë apo mund t'u dalë gjatë 5 vjetëve të fundit të punësimit të tyre, ku 1 vit nuk kanë qenë në punë. Jemi ende në një proces diskutimi, por dispozitat e këtij ligji nuk e prekin këtë kategori. Nuk është se nëpërmjet këtij ligji ne vendosim t'i përjashtojmë apo jo. Këtu nuk përmendet se nuk është targeti i këtij ligji përcaktimi i mbështetjes për këtë kategori. Ky është target i një grupi, i cili po punon për të bërë një vlerësim financiar, një vlerësim strategjik dhe se si do të mbështetet kjo kategori dhe cili prej tyre do ta mbështesë: Shërbimi Social Shtetëror apo do të rikthehet dhe do të mbështetet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore? Këta persona që janë invalidizuar gjatë 5 vjetëve të fundit janë persona që kanë kontribuar në skemën aktive të sigurimeve shoqërore. Në këtë pikë ne jemi duke vlerësuar se cila do të jetë struktura që do t'i mbështesë këto kategori.

Për sa i përket pyetjes suaj për sistemin e pikëzimit dhe formulën e unifikuar të pikëzimit, dua t'ju bëj me dije se kjo është një formulë, e cila ka disa parametra apo variabla që i shqyrton. Këto të fundit kanë të bëjnë kryesisht me situatën social-ekonomike të familjes, me demografinë, me qarkun ku ndodhet kjo familje, ka të bëjë me strukturën e familjes, si vlerësim, pra sa anëtarë janë në familje, asetet, si edhe të ardhurat që disponon apo jo kjo familje. Sistemi i pikëzimit ka disa koeficientë që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në ligjin aktual që propozohet, është po e njëjta gjë, që me vendim të Këshillit të Ministrave të përcaktohen koeficientët bazuar në parametrat dhe variablat. Këto të fundit, unë jua thashë janë disa kategori të përcaktuara në vendimet aktuale sipas reformës që kemi

ndjekur të ndihmës ekonomike dhe bazuar në këta koeficientë përlllogaritet edhe sistemi i pikëzimit që kualifikon individët apo familjet të jenë përfituese nga ndihma ekonomike. Dua t'ju bëj me dije se ne kemi vendosur tashmë prej 2 vjetësh të heqim vlerësimet që më parë bëheshin, ku përjashtoheshin familjet që kishin televizor, lavatriçe apo frigorifer. Këto janë hequr si parametra nga vlerësimi i familjeve nëse ato janë apo jo përfituese, duke konsideruar dhe duke bërë një vlerësim bazuar mbi konsumin e familjeve në raport me asetet që kanë, kryesisht asetet e lëvizshme dhe ato të palëvizshme. Sistemi elektronik është shumë i programuar në mënyrë të tillë që të vetëverifikojë në mënyrë dixhitale të gjitha të ardhurat, por edhe asetet e familjeve, duke filluar që nga makina, prona apo variabla të tjera që parashikon ky sistem.

Nga ana tjetër dua të përgjigjem edhe për sa i përket minimumit jetik. Është një pyetje që nuk është ngritur vetëm në këtë komision, është një çështje, e cila vlen për t'u diskutuar, por dua të jap këtu disa argumente, të cilat do të na vlejné edhe në të ardhmen në raport me përcaktimin e niveleve të varfërisë dhe minimumit jetik. INSTAT-i është duke punuar dhe së shpejti, brenda këtij viti do të nxjerrë vlerësimin për sa i përket metodologjisë, pra vlerësimin, i cili bazohet mbi konsumin dhe do të jetë një moment, i cili do të na hapë rrugën drejt rishikimit të metodologjive për të përcaktuar dyshtemenë apo tavanet për sa i përket ndihmës që do t'u jepet familjeve në raport me nevojën që kanë për t'u mbështetur nga skema e mbrojtjes sociale. Pra, metodologjia që është duke punuar INSTAT-i do të jetë një *baseline* shumë e mirë, që do të na ndihmojë më pas për të bërë vlerësimet për kalkulimet e varfërisë, të niveleve të tyre, në mënyrë që të jemi shumë më të saktë për sa u takon tavanëve apo edhe minimumeve të ndihmës sociale, që një familje apo individ duhet të ketë në momentin që përfshihet në skemën e ndihmës ekonomike.

Për sa i përket arsimit profesional, me të drejtë ju ngrini shqetësimin, dakord në zonat urbane është shumë më e lehtë të bashkëpunohet me Shërbimin Social Shtetëror, me Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe mund të drejtosh anëtarët madhorë të familjes për t'u aftësuar profesionalisht, po në zonat rurale si i bëhet? Ju e dini se tashmë prej 6 vjetësh qeveria ka ndërmarrë programin për rijetësimin e shkollave profesionale dhe të konvikteve të tyre. Ky është një hap i mëtejshëm drejt incentivimit edhe të atyre familjeve që janë në zonat rurale, anëtarëve të familjeve të tyre për t'u aftësuar profesionalisht duke përfituar nëpërmjet shkollave profesionale, me qëndrim të përhershëm, siç janë rivitalizimi i rrjetit të konvikteve që është një mundësi më tepër për të qenë dhe për t'u aftësuar në shkollat e aftësimit profesional.

Nga ana tjetër ligji që miratojmë sot jep edhe një garanci më shumë për bashkëpunimin nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror, zyra të punës dhe të gjitha strukturave të aftësisë profesionale që nëpërmjet trageleve të përcaktuara të mundësojnë planet individuale të familjeve me ndihmë ekonomike, të anëtarëve në moshë madhore të tyre, për aftësi profesionale dhe punësimin. Punësimi i qëndrueshëm mbetet një ndër objektivat dhe prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të qeverisë shqiptare për personat të cilët përfitojnë nga programet e mbrojtjes sociale, në mënyrë që ata të dalin nga këto programe dhe të jenë të gatshëm të përballen me jetën duke u mbështetur nëpërmjet programeve të punësimit të qëndrueshëm dhe aftësisë profesionale.

Për sa u përket skemës apo programeve që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale po elaboron edhe në kuadër të një komplementarizimi të skemës së mbrojtjes sociale, që ne bëjmë për kategoritë në nevojë, përfitimet në kesh janë një mundësi që japim nëpërmjet ligjit “Për asistencën sociale”, por nga ana tjetër është shumë i rëndësishëm përfitimi në shërbime. Shërbimet janë po aq të rëndësishme sesa edhe ndihma ekonomike, ajo që jepet në kesh, në pagesë. Në këtë kuadër ne si ministri kemi alokuar këtë vit fondet për programin e fondit social, ku mbështesim bashkitë e ndryshme të vendit, të cilat nuk kanë të ngritura shërbimet sociale në territor, për të ngritur shërbime sociale për kategoritë në nevojë, duke filluar nga shërbimet për komunitetin rom dhe egjiptian, për personat me aftësi të kufizuara, për fëmijën dhe gruan, për gratë e trafikuar dhe të dhunuara, në mënyrë që edhe në ato bashki ku nuk ka ende të ngritura shërbimet sociale, të mund të ngrihen nëpërmjet fondit social. Ky i fundit është një instrument i ri që qeveria shqiptare ka vënë në dispozicion dhe u vjen në ndihmë bashkive për të ngritur shërbime sociale duke garantuar buxhete nga qeveria. Pra, është një element më shumë për të garantuar mbështetjen për personat, të cilët kanë nevojë të mbështeten me shërbime dhe jo vetëm me pagesa në kesh. Këto janë programe komplementare dhe një tjetër program që është po aq i rëndësishëm është ai i ndërmarrjeve sociale. Kur flasim për punësimin, për arsimin profesional, duhet që të gjejmë mënyra dhe programe të qëndrueshme për t’u ardhur në ndihmë organizatave fitimprurëse për të ndërtuar programe të qëndrueshme të punësimit dhe ndërmarrjet sociale janë një instrument tjetër që buxhetohen këtë vit dhe do të vijohet edhe në vitet në vazhdim për punësimin e kategorive vulnerabil. Targeti i familjeve apo anëtarëve në moshë pune të familjeve me ndihmë ekonomike është një ndër kriteret që një organizatë jofitimprurëse duhet të përmbushë në mënyrë që të përfitojë nga fondet për ndërmarrjet sociale. Prandaj instrumente të tilla që po ngrihen paralelisht me skemën e asistencës sociale janë të duhurat për të bërë të mundur që përpos ndihmës që u jepet familjeve në një kohë dhe në një moment të caktuar të jetës së tyre kur janë në vështirësi,

të jenë po aq të orientuara dhe programet të cilat i nxjerrin nga ndihma ekonomike dhe i çojnë drejt një punësimi të qëndrueshëm dhe drejt integritit në shoqëri.

Enver Roshi - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Ardiana Jaku – Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një pyetje në lidhje me hapësirën e vogël të abuzivizmit që ende ka kjo skemë. Sistemi elektronik ka hequr pjesën e madhe të abuzivizmit dhe prandaj kanë dalë nga skema shumë përfitues që e merrnin atë padrejtësisht, por në terren ne kemi ende familje që pretendojnë se ndoshta në momentin e hedhjes së të dhënave në sistem mund të bëhet ndonjë abuzim. A ka një mekanizëm që i mbron këta qytetarë, ku mund të ankohen? Përgjithësisht janë edhe me nivel arsimor të ulët, nuk arrijnë ta plotësojnë siç duhet vetë formularin. Aty është një punonjës që bën hedhjen e të dhënave në sistem. Si t'i mbrojmë këta qytetarë? Ku t'i drejtojmë që të ankohen?

Për sa i përket programit tjetër të marrjes së ndihmës ekonomike për personat me aftësi të kufizuara, pagesën për aftësi të kufizuar, edhe aty kam pasur raste ankesash nga qytetarët, të cilët pretendojnë ose u takon pagesa e aftësisë së kufizuar. Personi thotë se është i verbër, nuk shikon fare, familjarët e pretendojnë këtë gjë, ndërkohë që ai është paraqitur para kempit epror, por nuk i është dhënë kjo e drejtë. Në këtë rast, a ka një shkallë ankimi? A ekziston një komision mbi komisionin e kempit epror, ku të mund të drejtohen këta persona?

Faleminderit!

Enver Roshi – Ka pyetje të tjera? Klodi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Epo mirë.

Florenc Spaho – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre, për gjithë atë përmbledhje shteruese që bëtë! Ishit shumë e qartë në të gjitha pikat që përmendët. Kam diçka në lidhje me nenin 13, te pagesa e aftësisë së kufizuar: “Përfituesve të klasifikuar me vendim të komisionit në grupet e aftësisë së kufizuar u ndërpritet pagesa pas 48 muajsh punësimi.”

Faktikisht, prej vitesh jam marrë me personat që kanë aftësi të kufizuar. Ka prej atyre që janë me arsim profesional apo edhe që kanë mbaruar universitete, të cilët duan të integrohen në shoqëri, të punojnë në administratë publike apo në biznese private, në bazë të profesioneve që kanë kryer.

Ndërprerja pas 48 muajsh punësimi e pagesës së aftësisë së kufizuar të këtyre personave, pra afërsisht pas katër vjetësh, më duket jo e drejtë. Kjo nuk do të thotë se pas katër vjetësh, këta persona janë rehabilituar apo e kanë përfutur atë pjesën e kufizimit. Ata duan të integrohen e të jenë si të tjerët, por këtë e bëjnë me vështirësi. Pra, le të marrim parasysh se janë persona të verbër, persona paraplegjikë, të cilët qëndrojnë në karroca me rrota. Në qoftë se ata punojnë në administratën shtetërore apo diku tjetër, kjo do të thotë se ata duan të ndjehen të barabartë. Pas 48 muajsh që janë të punësuar, nuk do të thotë se i kanë rifutur këmbët apo sytë. Heqja e pagesës së aftësisë së kufizuar, pra heqja e kempit që ata marrin, qoftë për veten apo për kujdestarin, e penalizon, që do të thotë: pasi këta persona të jenë punësuar, duhet ta paguajnë detyrimisht nga rroga e tyre kujdestarin apo ndihmësin personal, siç thatë ju. Me sa di unë, dhe me sa informacion kam, deri në 2018-ën nuk bëhen më shumë se 100 persona ata që janë punësuar. Pra, është një pagesë e papërfillshme e shtetit për këta persona. Në të njëjtën kohë, në qoftë se ne ia lejojmë përherë këtë lloj ndihme që ata marrin nga shteti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, nuk marrin asistencë sociale, por marrin aftësinë e kufizuar, marrin kempin. Ne duhet ti stimulojmë këta persona, që përveç rrogës të marrin edhe kempin. Faleminderit!

Arben Kamami – Faleminderit, kryetar!

Zonja Ministre, faleminderit që jeni këtu! Faleminderit edhe për mënyrën se si e parashtruat këtë projektligj të ri!

Si mjek dhe si person që kam punuar disa kohë pranë komisioneve mjekësore, kam vetëm një pyetje. Në një nga nenet, më falni që nuk më kujtohet numri, thuhet e pagesa e paaftësisë së përkohshme në punë ndërpritet në qoftë se personi shkon mbi tre muaj jashtë shtetit.

Mendoj se duke pasur parasysh edhe shpërbërjen e familjes shqiptare sot, ku fëmijët apo një nga anëtarët e familjes zhvendoset për shumë kohë jashtë shtetit, më duket e në kushtet tona është jo e përshtatshme. Sepse një i sëmurë, një invalid, qoftë për arsye mjekësore, qoftë dhe për arsye jomjekësore, po për arsye ekonomike, mund të lëvizë dhe të qëndrojë më shumë se tre muaj jashtë Shqipërisë. Nuk e shoh të arsyeshme që t'i ndërpritet pensioni i invaliditetit, nëse ai është brenda kritereve, ama me kushtin kryesor që brenda vitit të plotësojë ato problemet që lidhen me ekzaminimet mjekësore paraprake. Ju faleminderit!

Klodiana Spahiu – Përshëndetje!

Së pari do të doja t'ju falënderoja, sepse realisht është një ligj që ka qenë shumë i rëndësishëm për ne. Shpeshherë kemi debatuar për probleme të ndryshme që ka ndihma ekonomike, por edhe personat me aftësi ndryshe.

Në vitin 2014, ne kemi kaluar ligjin “Për personat me aftësi ndryshe” dhe besoj se tashti është momenti që edhe një rikomisionim i tyre në bazë të këtij komisioni të ri, do të jetë më me vlerë për të përcaktuar atë që ka nevojë dhe atë që duhet të përfitojë maksimumin.

Kur u bë pilotimi i ndihmës ekonomike, ai filloi në tre qarqe kryesore, për të vazhduar më pas në gjithë Shqipërinë. Besoj se e njëjta situatë do të ndodhë edhe me pilotimin për personat me aftësi ndryshe, mbi bazën e këtij rikomisionim.

Doja të dija nëse ka filluar apo jo ky komisionim në ndonjë rajon pilot apo nuk ka filluar ende, dhe cilat janë rezultatet e para? Pyetja e parë kjo.

Pyetja e dytë ka të bëjë me përfitimin në natyrë. Çfarë nënkuptoni ju me përfitim në natyrë?

Pyetja e tretë, që e ngriti pak më parë edhe një nga kolegët, ka të bëjë me minimumin jetik. Ju thatës e po bëhet një vlerësim mbi konsumin. Në fakt, ka disa metoda për të përcaktuar minimumin jetik. Besoj se në momentin që do të vlerësohet minimumi jetik, ky do të jetë një hap shumë i rëndësishëm për qeverinë e për ne, sepse do të dimë ku jemi me ndihmën ekonomike e me të gjitha ato çfarë u ofrohen njerëzve në nevojë. Në këtë rast, shqetësimi im lidhet me familjet që jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme. A do të ketë ndonjë përgjegjësi administratori shoqëror për përcaktimin e këtyre familjeve që gjenden në varfëri ekstreme në zonën që ai mbulon?

Domethënë, nuk është fjala për ndihmë ekonomike. Besoj se në një nga nenet që ju keni përmendur, që është ndihma urgjente, ne mund të saktësojmë që të ketë një lloj mbështetjeje të menjëhershme në momentin që konstatohen këto familje. Realisht, është e vështirë. Unë e kuptoj se edhe konstatimi nuk është shumë i thjeshtë, po të kemi parasysh terrenin në Shqipëri, si dhe faktin se shpeshherë këto familje shumë të varfra gjenden në terrene shumë të vështira.

Prej disa vitesh ekziston një projekt i qeverisë, që merret me ndihmën që u jepet këtyre familjeve, por përsëri besoj se nuk është aq kollaj t’i mbulosh këto raste. A do të përcaktoni në ligj ndonjë përgjegjësi të këtij administratori, deri më tash nuk ka, që të jetë përgjegjësi e tij në rastet konkrete?

Dhe tani shqetësimi i fundit, të cilin e kam ndarë me ju që prej shumë vitesh, ishte edhe shqetësimi i kryetarit të komisionit. Ndoshta është momenti t’i japim zgjidhje kërkesës që ne kishim. Është ngritur grupi i punës, ne jemi në dijeni të grupit të punës, por shpresojmë që të paktën të gjendet një zgjidhje për rastet që kanë të bëjnë me sëmundje realisht të rënda...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sëmundje terminale, por në qoftë se bëhet ndryshimi... Rastet nuk është se janë shumë, por shpresoj të kemi një zgjidhje. Faleminderit!

Enver Roshi – Ka pyetje të tjera? S’ka pyetje të tjera.

Atëherë, zonja Ministre, meqenëse jashtë ka persona me aftësi të kufizuara, që mezi lëvizin dhe janë në pritje, do t’ju lutesha që përgjigjet të ishin sa më të shkurtra, që të mund të fillonim seancën me ta. Faleminderit!

Ogerta Manastirliu – Për sa u përket pyetjeve në lidhje me ankesat, apo nëse ky ligj vendos një metodologji për proceset e ankimit, po, ky ligj parashikon proceset e ankimit, procese qoftë për çështjet e skemës së ndihmës ekonomike, qoftë për pagesat e paaftësisë së kufizuar. Në të dyja këto programe përcaktohen afate për ankimet: për ndihmën ekonomike tek administratori social, ndërsa për çështjet e ankimit në lidhje me pagesat për paaftësinë, do të jetë shërbimi social shtetëror. Do të jenë të gjitha strukturat, duke shkuar deri te kempit epror.

Megjithatë, për rastet kur ankimi nuk zgjidhet tek institucione që kanë përgjegjësinë për zbatimin e skemës, ne kemi vendosur edhe një shkallë tjetër, që është shkallë e gjykatës administrative, e cila merret me zgjidhjen e këtyre ankesave. Pra, këtu e ezaurojmë çështjen e ankesave.

Çështja tjetër, ajo në lidhje me abuzivizmit dhe në lidhje me ato familje që kanë pretendime, të cilat mund të mos kenë përfituar pikët nga sistemi i pikëzimit, por se si do të trajtohen kur kanë vërtet nevojë, dua t’ju them se Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror vendos e 6 % të buxheteve për çdo bashki të jetë në funksion të bashkive, që me kriteret që vendos këshilli bashkiak të përcaktojë ato familje, të cilat mund të kenë mbetur të papikëzuara nga sistemi elektronik i pikëzimit.

Pra, u jep një hapësirë bashkive, që të përfshijnë në skemën e ndihmës ekonomike edhe familjet që mund të kenë mbetur jashtë sistemit të pikëzimit, meqenëse dihet se skema e pikëzimit është sistem elektronik, një sistem i ftohtë, i cili parashikon ato variabla që janë të pikëzuara me koeficient në këtë sistem elektronik. Prandaj, kjo mundësi u jepet vetë bashkive, me qëllim që ato familje të mund të mbështeten nëpërmjet 6 % të fondeve, të cilat përsëri jepen nga qeveria.

Për sa i përket çështjes që u ngrit në lidhje me problematikën, siç ngrihet në raport me përfitimin e pagesës së paaftësisë në raport me individët që janë të punësuar, për ta përfituar atë përgjatë gjithë jetës, dua t’ju saktësoj diçka.

E para, duhet të dimë se deri në vitin 2016, ata persona, ata individë që kanë qenë subjekt i punësimit, përfitimin e masës së aftësisë së kufizuar e kanë marrë deri për dy vjet.

Në bazë të vendimit të qeverisë, ky ligj ngurtëson tashmë përfitimin për katër vjet. Pra, në këtë ligj e kemi rritur edhe me dy vjet. Për katër vjet do ta përfitojnë pagesën e aftësisë. Pas

katër vjetësh, ata do të mund të përfitojnë të gjitha kompensimet e tjera: do të përfitojnë edhe ndihmësin, nëse kanë nevojë për ndihmës, do të përfitojnë edhe kompensimet e energjisë elektrike, të shkollimit, të gjitha.

Pra, ndihma nuk kufizohet për personat që punësohen. Rritet nga dy vjet në katër vjet, dhe të gjitha kompensimet e tjera i marrin. Nga ana tjetër, çka është më e rëndësishme: nëse ata e humbin punën e tyre, kanë të drejtë të riaplikojnë dhe të përfshihen përsëri në skemë.

Pra, nuk u kemi hequr asnjë të drejtë të fituar. Përkundrazi, në këtë ligj po e rrisim të drejtën e tyre të përfitimit deri në katër vjet, pasi deri më 2016 e kanë pasur dy vjet. Po ashtu, u jepet mundësia të përfitojnë të gjitha ato kompensimet e tjera, që i kanë në paketën e tyre të suportit.

Për sa i përket pyetjes që bën me të drejtë zonja Spahiu, se çfarë janë përfitimet në natyrë: përveç shërbimeve që jepen në kuadër të sistemit të mbrojtjes sociale, janë gjithashtu edhe përfitimet në ushqime e në veshmbathje, të cilat mund të përfshihen në skemën e mbrojtjes sociale, për sa i përket programeve të mbrojtjes dhe bashkëpunimeve me bashkitë apo organizatat jofitimprurëse. Konceptohet që përveç ndihmës në kesh, të ketë edhe përfitime në natyrë, të cilat mund t'i parashikojë kjo skemë. Përfitimet në kesh janë pjesë e përfitimeve financiare të programit të ndihmës ekonomike apo programit të pagesës së aftësisë së kufizuar, ndërsa përfitimet në natyrë janë mbi këto, në kuadër të bashkëpunimit me bashkitë, në kuadër të planeve sociale të bashkive apo organizatave jofitimprurëse, donatorëve, bizneseve e të tjera.

Për sa i përket tremujorit, duke konsideruar pyetjen tuaj, dua t'ju them se ky ligj parashikon ato çfarë parashikojnë edhe dispozitat e tjera ligjore në raport me lejen e qëndrimit të personit jashtë vendit, leje e cila është 90 ditë apo tre muaj. Sigurisht, ne nuk e përjashtojmë nga përfitimi i pagesës, por nëse periudha e qëndrimit zgjatet më shumë se tre muaj, atëherë mendohet se ka marrë një leje qëndrimi në atë vend dhe po e bën jetën e tij jashtë kufijve të Shqipërisë, jashtë territorit të Shqipërisë. Në këtë pikë, nëse tejkalon tremujshin, që është koha e qëndrimit zyrtar për çdo person, humbet edhe përfitimin.

Besoj se këto ishin pyetjet.

Sa i përket ndihmës emergjente, do të doja të thosha se për çështje ekstreme apo fatkeqësitë natyrore, ky është një ligj që përcakton programet dhe dispozitat e skemës në kushte normale. Në kushtet e emergjencës, futet ligji i emergjencave civile, i cili jep mbështetje për këta qytetarë.

Enver Roshi – Faleminderit, zonja Ministre!

Në një kohë tjetër, nëse kemi nevojë për një seancë tjetër dëgjimore, ne do t'ju thërrasim sërish.

Ogerta Manastirliu – Patjetër!

Enver Roshi – Desha të shtoja këtu, se për të gjithë administratorët socialë ndoshta nga ana juaj ka nevojë për një trajnim juridik të implementimit të ligjit, i cili duhet të parashikohet, pasi interesi i disa njerëzve në Shqipëri është që sa herë del një ligj ta kthejnë atë në natyrë abuzive, sepse ky është mentaliteti se si ne i shohim gjërat. Prandaj, këtyre njerëzve u duhet qëndruar në këmbë, ju lutem, sepse kemi njerëz që presin jashtë...

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Ministre, për katër vjet ata i përfitojnë të gjitha ato që i kanë përfituar para se të punësohen, apo jo? Jam duke folur për nenin 13. Pas 4 vjetëve, kush ikën? Ikën vetëm ata që kanë KEMP?

A mund të ketë raste të tilla që në krye të 3 vjetëve e gjysmë apo të 3 vjet e 11 muaj ai person shkëputet nga puna për 3 apo 6 muaj dhe mund të rikthehet pastaj për 4 vjet me të drejta të barabarta? Apo 4 vjet mjaftojnë?

Pra, kjo do të thotë që ai që punon përfiton përsëri pas 4 vjetëve.

Ogerta Manastirliu – Në rastet kur pas 4 vjetësh ndërpriten marrëdhëniet e punësimit, riaplikon në skemë dhe përfiton po të njëjtën...

(Diskutime pa mikrofon)

Po, të gjitha.

(Diskutime pa mikrofon)

Patjetër, sepse kështu është e përcaktuar në ligj.

Enver Roshi – Zonja Ministre, seanca nuk është mbyllur ende.

Hedhim në votim në parim ligjin. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet ligji në parim.

Këtu mbyllet seanca.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Roland Xhelilaj Ervis Meço, Edmond Stojku dhe Halil Jakimi.

Mungojnë:

Klotilda Bushka dhe Amra Barova

Të ftuar:

Florida Kalemi – Përfaqësuese e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kuafizuara

Sidita Fortuzi - Përfaqësuese e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kuafizuara

Dritan Hoxha - Përfaqësues i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kuafizuara

Abdulla Omuri – përfaqësues i Shoqatës së Invalidëve të Punës së Shqipërisë

Rovena Vuksani – Përfaqësuese e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Iva Plaushku - Përfaqësuese e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Iva Zajmi – Përfaqësuese e UNICEF-it

Moza Morina – Ndihmëskomisionere e Avokatit të Popullit

Matilda Tyli - Ndhmëskomisionere e Avokatit të Popullit

Ines Leskaj – përfaqësuese e AWEN

Franc Tahirati – Përfaqësues i Komitetit Egjiptian dhe Rom

Fatjona Caka - Përfaqësues i Komitetit Egjiptian dhe Rom

Merita Xhafaj - Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale

Eneida Capo - Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëdita!

Pak më parë kishim seancën e parë dëgjimore me Ministrinë e Shëndetësisë për projektligjin “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa tani kemi seancë dëgjimore me grupet e interesit.

Të pranishëm në komision është Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, i përfaqësuar nga zonjat Floida Kalemi, Sidita Fortuzi dhe zoti Dritan Hoxha. Nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë është zoti Abdulla Omuri, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit zonjat Roveni Vuksani dhe Iva Plaushku, nga UNICEF-i e pranishme është zonja Iva Zajmi, nga institucioni i Avokatit të Popullit janë zonjat Moza Morina ndihmëskomisionite dhe Matilda Tyli ndihmëskomisionere, nga AWEN e pranishme është zonja Ines Leskaj, nga Komiteti Egjiptian dhe Rom të pranishëm janë zoti Franc Tahirati dhe zonja Fatjona Caka dhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale janë zonjat Merita Xhafaj, drejtoreshë e Përgjithshme dhe Eneida Capo, përgjegjëse sektori.

A ka të ftuar të tjerë që nuk e kanë dëgjuar emrin? Nuk ka.

Do t’ju lutesha që në momentin kur merrni fjalën të prezantoheni, emrin dhe institucionin që përfaqësoni, në mënyrë që kur të zbardhet të jenë të regjistruar të gjithë emrat.

Fjalën e kanë përfaqësuesit e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Sidita Fortuzi – Përshëndetje dhe faleminderit për ftesën!

Unë quhem Sidita Fortuzi dhe jam menaxhere projektsh pranë Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Në fakt, ne i kemi dhënë edhe me shkrim opinionet, komentet tona, si dhe disa pikëpyetje që kishim në lidhje me projektligjin për asistencën sociale, por dëshirojmë të ndajmë me ju disa nga çështjet më kryesore.

Do të përpiqem të jem sa më koncize dhe shpresoj që më pas të kemi mundësinë për t’i sqaruar sa më në detaje të gjitha opinionet, mendimet, komentet dhe pyetjet që kemi.

Së pari, ky ligj të jep një mundësi shumë të mirë për të bërë një dallim përfundimtar mes karakterit të ndihmës ekonomike dhe pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar. Të dyja këto çështje së bashku i gjejmë që në fillim të projektligjit, te qëllimi, i cili më pas pasohet nga një argument, i cili shkon përtej ndihmës ekonomike. Ne propozojmë që të ndahet natyra e

ndihmës ekonomike, e cila ka një karakter ekonomik-social dhe pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar, e cila shkon si kompensim i aftësisë së kufizuar dhe jo si një pagesë që ka natyrë ekonomike.

Kjo është shumë e rëndësishme, pasi përgjatë gjithë tekstit ligji ka shumë probleme, sidomos ai që lidhet me punësimin ose me ndërprerjen e pagesës, kjo ndoshta për shkak të mospërcaktimit të saktë se çfarë do të jetë kjo pagesë, nëse ajo do të jetë për shkak të aftësisë së kufizuar, ku do shkojë dhe për çfarë do të shpenzohet.

Mendimi ynë është që kjo duhet të shërbejë për integrimin sa më mirë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Edhe pse janë marrë masa të rëndësishme dhe është përmirësuar situata e aksesueshmërisë dhe e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri vitet e fundit, qoftë përmes përmirësimit të legjislacionit dhe zbatimit efektiv të tij, sërish mbetemi në kushtet e përjetimit të barrierave të jashtëzakonshme në të gjitha fushat e jetës të personave me aftësi të kufizuara. Kjo pagesë do të shkojë pikërisht për përmirësimin dhe për tejkalimin e këtyre barrierave në jetën e përditshme dhe në fusha të ndryshme.

Sa u takon parimeve kemi një përsëritje të mosdiskriminimit, mosdiskriminimi dhe barazia, prandaj për këtë arsye ne propozojmë që kjo përsëritje të shmanget, por ky është një problem që zgjidhet lehtësisht. Ne kemi vendosur thjesht që të jetë aty.

Në nenin 5, pika “i”, ka një përkufizim për komisionet shumëdisiplinore. Ne jemi të ndërgjegjshëm që jemi ende në fazën e një reforme të vlerësimit, pra do të kalojmë nga një model mjekësor në një model biopsikosocial, i cili po bëhet pjesë e vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara, si dhe do të ketë një ligj, i cili do ta rregullojë në mënyrë të posaçme vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara. Ne propozojmë që këtyre komisioneve, të cilave tentohet t’u jepet një natyrë jo më mjekësore, por një natyrë sociale, të cilat përbëhet nga një mjek dhe një punonjës social të kenë një hapësirë, e cila mund të shërbejë në të ardhmen, sepse mund të ketë profesionistë të tjerë që do të vlerësojnë personat me aftësi të kufizuara, përveç mjekut dhe punonjësit social.

Ne e dimë që deri tani janë dy profesionistë nëpër këto komisione, por duke u lënë hapësirë do të ketë më shumë se një mjek apo punonjës social, pra edhe profesionistë nga disiplina të tjera. Ne kemi dhënë propozimin konkret se si mund të arrihet kjo, pasi në të ardhmen kjo mund të ndihmojë në përparimin e avancimit të modelit biopsikosocial.

Në pikën “m” është problemi i përkufizimit të pagesave. Ne mendojmë se mund të bëhen më shumë përpjekje për ta përcaktuar më mirë se ku do të shkojnë dhe se si do të jenë pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar të jetë edhe qëllimi se ku do të shkojë kjo pagesë, si dhe të unifikohet terminologjia gjatë gjithë tekstit.

Sa i përket ndihmësit personal propozojmë të ketë një përputhje më të mirë me ligjin për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Megjithatë këtë e gjejmë të reflektuar në nenet 3 dhe 8 të ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë, ku parashikohen masat, kriteret dhe mënyra se si do të përzgjidhen ndihmësit personal, kemi dhënë një mendim që kjo gjë të jetë e reflektuar më mirë, sidomos duke iu referuar pikërisht këtyre dy neneve. Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë është ligji kyç që zgjidh çështjen e ndihmësve personalë, prandaj ne mendojmë që edhe këtu të ndryshohet terminologjia, pasi aty përmendet personi që përkujdeset. Ne mendojmë se do të ishte më mirë që të bëhej “personi që ofron asistencën personale”, sepse duke u përmendur terminologjia e vjetruar inkurajojmë përsëri një model mjekësor, ndërkohë që ndihmësi personal e ndryshon komplet filozofinë. Ky mund të jetë një person që i ofron asistencë një personi me aftësi të kufizuara fizike, mund të jetë interpret i gjuhës së shenjave, por mund të jetë edhe një shoqërues në rastin e personave të verbër.

Sa i përket përkufizimit të termit “paraplegjik”, propozojmë që të jetë “person paraplegjik”. Është shumë e rëndësishme të përdoret sërish një model social, duke nënvizuar jo diagnozën, por personin. Minimalisht duhet të përdoret termi “person paraplegjik” nëse duam ta përdorim dhe ta veçojmë, meqenëse ka ligje të posaçme që rregullojnë pjesën e personave paraplegjik dhe tetraplegjik dhe kjo shkon në përputhje me statusin për personat invalidë.

Gjithashtu, ka një qasje të modelit mjekësor ku ende përdoren shprehje të tipit “të cilët deklarohen të paaftë për punë, personat me aftësi të kufizuara”. Ne ende nuk e dimë nëse ky ligj do ta ndajë përfundimisht modelin mjekësor nga modeli biopsikosocial, sepse këtu janë përmendur të dyja komisionet, komisioni në formën e tij të vjetër të caktimit të aftësisë për punë, por edhe komisioni i ri shumëdisiplinor. Ne e dimë që kjo është bërë për personat që janë vlerësuar nga ky komision, por mendojmë se do të ishte më mirë që kjo të ishte në dispozita tranzitore dhe të kishte një parashikim më të saktë, duke u bazuar te përfituesit, pra te modeli biopsikosocial.

Po ju jap një shembull. Përfitues të pagesës janë të gjithë personat që janë vlerësuar nga komisioni shumëdisiplinor i personave me aftësi të kufizuara, sipas vlerësimit biopsikosocial ose IFC, për të rinjtë dhe të rriturit, për të ardhur në përputhje edhe me atë që synon vetë reforma për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Një nga problemet më thelbësore që ne kemi me këtë projektligj ka të bëjë me humbjen e pagesave pas 48 muajve të punësimit të personave me aftësi të kufizuara, pa bërë këtu ndonjë dallim mes grupeve të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara. ADRF-ja ka bërë disa

studime për të parë se si kjo ndikon në punësim. Pra, ndërkohë që ne kemi marrë edhe reforma të jashtëzakonshme për nxitjen e punësimit, duke pasur edhe një ligj të ri, i cili i nxit vërtet personat me aftësi të kufizuara për t'u punësuar në tregun e hapur të punës, ky ligj duket sikur e frenon këtë punësim, duke i demotivuar personat. Përmes disa sondazheve, studimeve dhe praktikave të shumta ndërkombëtare që ne kemi kryer rezulton se heqja nga skema e pagesave të aftësisë së kufizuar i frenon personat me aftësi të kufizuar të punësohen. Personat me aftësi të kufizuar në bazë të studimeve ndërkombëtare, sepse në nivel kombëtar fatkeqësisht nuk i kemi të sakta, kërkojnë 2 deri 3-fish më shumë shpenzime për shkak të aftësisë së kufizuar që përjetojnë. Pikërisht për këtë arsye pagesat për personat me aftësi të kufizuar nuk duhen hequr, por kjo duhet kombinuar me mungesën e aksesit. Kur them aksesit, nuk e kam fjalën vetëm për atë fizik, por në gjithë kuptimin e aksesueshmërisë apo të nivelit të diskriminimit që ata përjetojnë ende në tregun e punës, pavarësisht përpjekjeve pozitive që janë ndërmarrë.

Gjithashtu, ka edhe disa probleme me procedurat dhe mënyrën se si do të hiqen pagesat. Këshilli i Ministrave duhet të japë një rekomandim për rikthimin në skemë, por unë mendoj se duhet të ishte edhe një vendim tjetër për të rregulluar pjesën se si u ndërpritet pagesa, pasi vendimi për dhënien e pagesës jepet nga komisioni, ndërkohë që mendimi për heqjen e kësaj pagese jepet nga bashkia. Megjithatë, këto janë detaje, të cilat mund të diskutohen më vonë. Ne mendojmë se është e rëndësishme të rregullohet përkufizimi i pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar, sepse pa u rregulluar kjo pagesë do të ketë gjithmonë probleme.

(Diskutime pa mikrofon)

Është e rëndësishme që të gjithë ta kuptojnë se personat me aftësi të kufizuara japin kontributin e tyre, pra paguajnë sigurimet shoqërore dhe neve na kthehet shumëfish punësimi i personave me aftësi të kufizuara pa prekur dhe pa cenuar standardin e tyre, duke pasur barriera dhe shpenzime, gjë të cilën nuk e kanë personat që nuk i kanë këto aftësi të kufizuara.

Kemi edhe rastin e personave me statusin e invalidit të verbër, që nuk e humbasin pagesën në çastin e punësimit. Ata nuk i gjejmë si grup përfitues në këtë projektligj. Kjo është një praktikë e mirë, e cila duhet ndjekur edhe për kategoritë e tjera të personave me aftësi të kufizuara, pasi krijojmë diskriminim mes grupeve me aftësi të kufizuar. Nuk duhet konfunduar pagesa për aftësi të kufizuar me shërbimet apo mbështetjen që mund t'i jepet një personi me aftësi të kufizuar.

Këto janë komentet tona, të cilat i kemi dërguar me shkrim.

Dritani, si përdorues i karriges me rrota dhe si i punësuar, do të ndajë me ju historinë e tij personale në lidhje me problemet që ai ka nga ndërprerja e pagesës së aftësisë së kufizuar.

Enver Roshi – Faleminderit!

Dritan, fjala është për ju. Ju lutem sa më shkurt.

Dritan Hoxha – Ju falënderoj!

Unë kam 13 vjet në marrëdhënie pune në Bashkinë e Elbasanit. Problemi im ka lindur që në vitin 2014 me ndryshimin e nenit për nxitjen e punësimit, me vendosjen e limitit për pagesën që merr kategoria që unë përfaqësoj. Kjo na ka cenuar dhe na demotivon në integrimin tonë në shoqëri, prandaj jemi kundër. Pra, një person me gjithë atë investim që ka bërë në jetën e tij ndodhet në vështirësi, sepse i hiqet pagesa që merrte si person me aftësi të kufizuar.

Më kujtohet fjala e zotit Rama pas zgjedhjeve, i cili tha: “Kjo qeveri ka gjëra që i ka bërë shumë mirë, ka gjëra që i ka bërë mirë, por ka edhe ca gjëra që janë bërë gabim dhe tani mendoj se është momenti për t’i korrigjuar”.

Unë kërkoj mbështetjen e të gjithëve anëtarëve të komisionit për rishikimin e këtij ligji dhe heqjen e limit kohor, pasi këto të ardhura që u takojnë invalidëve janë shumë të rëndësishme.

Në nenin 15 të ligjit nr. 8626 për paraplegjikët, i dalë në vitin 2000, thuhet: “Këto të ardhura nuk llogariten si të ardhura mujore”. Pra, ky ligj ka përplasje me legjislacionin, prandaj kërkoj mbështetjen tuaj për ndryshimin e këtij ligji. Ne e kemi parashtruar edhe në rekomandimet tona dhe shpresojmë të gjejmë mirëkuptimin tuaj.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, Dritan!

Përfaqësuesja e Ministrisë së Shëndetësisë, zonja Merita Xhafaj, a mund t’i ktheni një përgjigje Dritanit?

Merita Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e njoh si kërkesë, sepse është sjellë disa herë. Por duhet theksuar, sikurse e tha edhe ministrja, se kjo gjë nuk është bërë gabim, por përkundrazi është rritur afati kohor. Në vitin 2016 është bërë një ndryshim ligjor dhe pagesa nga 24 muaj është bërë 48 muaj. Pasi kalojnë 48 muaj, ndërpritet vetëm pagesa e kempit dhe të gjitha përfitimet e tjera, ku përfshihet kujdestaria, pagesa e karburantit, kompensimi i energjisë elektrike e të tjera, nuk hiqen. Nëse mendoni që kjo duhet të ndryshojë, ne mund ta rishikojmë, por do t’ju ndërpriten dhe shfuqizohen statuset. Pra, nëse do të lihet në fuqi kjo, atëherë statuset e tjera do të shfuqizohen, sepse ne kemi edhe një ligj tjetër për aksesueshmërinë dhe pjesa e punësimit, atë që thoni ju, është e lidhur me ligjin specifik për nxitjen e punësimit.

Zbatimi i ligjit të nxitjes së punësimit deri dje ka qenë nul, ndërsa sot është bërë një ligj i ri me disa kritere të reja për t’u zbatuar, të cilat deri dje nuk janë zbatuar, prandaj u ndërmor kjo nismë. Lidhur me këtë unë jam e bindur se në momentin që ka hyrë në fuqi ky ligj, pra që

nga viti 2016, pagesat për 48 muaj janë bërë kesh dhe korrekte. Pra këto pagesa janë bërë nga kjo qeveri dhe jo nga ajo që ka qenë më përpara, prandaj nuk është bërë gjë gabim, përkundrazi është bërë një përmirësim i situatës.

Kjo do të merret në konsideratë, por ne si ministri do të bëjmë mbrojtjen tonë.

Dritan Hoxha – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht, është te rekomandimet. Pra, kjo e ardhur që vjen për shkak të pagesës së aftësisë së kufizuar nuk duhet llogaritur me të ardhurat e tjera. Ne u referohemi personave që kanë statusin të verbër, të cilët nuk penalizohen në limit kohor, as për dy dhe as për katër vjet. Ky është një rast pozitiv dhe ne nuk themi që të cenohen, por të mos bëhet diskriminim brenda grupeve me aftësi të kufizuar.

Merita Xhafaj – Ky ligj e ka të përcaktuar për të gjitha kategoritë që e kanë 48 muaj, përveç të verbërve. Të verbrit kanë specifika të tjera. Megjithatë, në kuadër të reformës për aftësitë e kufizuara, do të rishikohet i gjithë sistemi për një vlerësim biopsikosocial. Bazuar në atë sistem, shumë nga ligjet ekzistuese do të bien poshtë.

Enver Roshi – Po.

Florida Kalemi – Unë dua t'ju them se nuk duhet të ngatërrohet pagesa që jepet për shkak të aftësisë së kufizuar, sepse në të gjithë bazën ligjore thuhet se kjo pagesë jepet për shkaqe të gjendjes shëndetësore dhe nuk konsiderohet si e ardhur. Edhe kur llogaritet ndihma ekonomike për një familje, pagesa e aftësisë së kufizuar nuk llogaritet si pjesë e të ardhurave, prandaj nuk duhet të cenohet, sepse lidhet me gjendjen e individit.

Nëse ne u krijojmë këtyre kategorive një mundësi punësimi, atëherë të ardhurat duhen llogaritur mbi këtë pagesë, njësoj si pjesa tjetër. Duke bërë këtë gjë, ne i hapim rrugën reformës për nxitjen e punësimit, sepse personi është i motivuar. Pra, nëse një personi nuk i preken të ardhurat që merr për aftësinë e kufizuar, atëherë ai ka motivimin për të kërkuar punë, në rast të kundërt ai trembet nga humbja e kësaj pagese dhe nga mundësitë e pakta që ofron tregu i punës.

Shumica e personave me aftësi të kufizuara që janë të punësuar në punë kanë paga të pjesshme dhe të ardhura të vogla, por, nëse u hiqet pagesa, atëherë imagjinoni se çfarë mund t'i ndodhë asaj familje, pra duhet të jemi realistë në kontekstin shqiptar.

Kjo eksperiencë është edhe në vendet e tjera, ku pagesa për shkak të aftësive të kufizuar, nuk luhet.

Enver Roshi – Propozimi juaj është bërë?

Florida Kalemi – Është bërë dhe ne e kemi sjellë.

Të dyja reformat duhet të ecin paralelisht, pra si reforma e ndihmës dhe ajo e asistencës. Kjo është reforma e parë reale e nxitjes së punësimit, e cila më në fund do të jetë një reformë e vërtetë që do të nxisë punësimin, me ndryshimet që janë bërë në vitin 2019.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit!

Fjalën e ka përfaqësuesi i Shoqatës së Invalidëve të Punës së Shqipërisë, zoti Omuri.

Abdulla Omuri – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë përfaqësoj invalidët e punës dhe në emër të 75 mijë vetave kam dërguar materialin me shkrim.

Dua të falënderoj ekspertë që kanë punuar për projektligjin, sepse deri më sot nuk ka pasur një ligj të mirë, edhe pse invalidët janë trajtuar nga ligji nr. 7703. Unë kam punuar 12 vjet e gjysmë në minierë dhe aktualisht marr 78 mijë lekë të vjetër, prandaj më lind e drejta të trajtohem me skemën e ndihmës ekonomike nëse plotësoj kriteret, pra me anë të pikëzimit. Por kjo është bërë gabim, sepse nuk e kanë paraqitur se cili është pikëzimi.

Paraprakisht ligji është shumë pozitiv, por dihet, siç e dini edhe ju zonja dhe zotërinj deputetë, uji del i kulluar në fillim, pastaj vazhdon e turbullohet dhe nuk del asnjë pikë poshtë.

Konkretisht te neni 8 thuhet: “Subjektet”, këto nuk janë as subjekte zgjedhore, as politike, prandaj, sipas gjuhës shqipe, duhet shkruar “kriteret e kategorive që përfitojnë nga aftësia e kufizuar”.

Më poshtë duhet shtuar një shkronjë “d”, ku të thuhet: “Të verbrit janë lënë jashtë”, pavarësisht nga trajtimi.

Dëgjova përfaqësuesen e ministrisë, e cila tha: “do t’ju hiqen statuset”, por unë po ju them se, nëse dikush mund të luaj me zjarrin, atëherë mund të luajë edhe me të drejtat e miratuara në vitin 1994, sipas ligjit të Bismarkut, bashkë me sigurimet shoqërore. Unë kam punuar 12 vjet në nëntokë, ku kam lënë edhe pjesë të trupit dhe marr 78 mijë lekë në muaj, kjo është shumë e vështirë, zonjë. Këto politika të mbrapshta që janë ndjekur për 30 vjet na kanë çuar këtu.

Unë ju falënderoj shumë që i keni dhënë prioritet ligjit të punësimit dhe në veçanti daktoreshë Klodin, e cila ka qenë e pranishme, por nuk duhet të harroni se sot janë 28836 invalidë pune me të drejtë pune dhe asnjë nuk i merr në punë, sepse bizneset u thonë se nuk ka punë për njerëzit e shëndoshë. Kjo ndodh, sepse nuk ka një inspektorat pune dhe asnjë deputet nuk merr një nismë ligjore për të thirrur punëdhënësit apo ministrinë për punësimin e kësaj kategorie.

Si shembull keni Maqedoninë, ku një koleg yni merr 340 euro dhe, nëse punëdhënësi e mban 10 minuta jashtë orarit, e paguan dyfishin. Si do të ketë punësim, kur të gjithë politikanët janë të lidhur me bizneset e tyre.

Nëse doni të bëni shtet, duhet t'ua mblidhni bizneseve. Dëgjova një rast në një takim me Kryetarin e Kuvendit, ku një sipërmarrës tha: “Nuk kam punëtorë”. Si ka mundësi që nuk kishte punëtorë, kur edhe ata që i ka, i paguan me 20 mijë lekë? Zoti kryetar, prandaj po ju them se ju si komision duhet të shqetësoheni se vetëm për vitet 2017-2018 kemi 1800 vajza të reja, të cilat punojnë në fasoneri dhe kanë dalë në grupe invaliditeti. A keni menduar ndonjëherë se ato punojnë me helme? Kur unë isha në Valias më jepte...

(Diskutime pa mikrofon.)

Enver Roshi – Zoti Abdulla, përqendrohuni te projektligji.

(Diskutime pa mikrofon.)

Enver Omuri – Unë nuk ju njoh, por, në qoftë se jeni deputet, do ta shikojmë atë punë.

Enver Roshi – Zoti Abdulla, këtu jeni gjithmonë i mirëpritur! Ju lutem, vazhdoni!

Abdulla Omuri – Por realiteti që ne paraqesim këtu, nuk i pëlqen askujt, zoti kryetar!

Enver Roshi – Keni të drejtë!

Abdulla Omuri – Realiteti nuk i pëlqen askujt, sepse, ndryshe do të më thoshin: “Abdullah, ke të drejtë.”

Enver Roshi – Zoti Abdulla, mund të vazhdoni!

Abdulla Omuri - Së dyti, termi “i verbër” normalisht duhet të lihet në ligj.

Së treti, ju kërkoj ndjesë për tonin e zërit, por mos harroni se edhe unë jam invalid, zotëri, dhe duhet të keni kujdes kur flisni me mua. Kam punuar unë që je arsimuar ti, kam derdhur kontribut unë, që je arsimuar ti, ndaj, të lutem!

Në nenin 13, pika 2, thuhet: “Përfituesve të klasifikuar...”. Normalisht, jam kundër edhe me afatin 48 muaj, sepse, për mua, kjo pagesë pensioni është një hijë. Unë mendoj se kjo duhet të reduktohet, ashtu siç është te ligji nr. 7703 për invalidët e pjesshëm, të cilët janë të punësuar e të tjerë. Pra, duhet të gjenden mekanizma, sepse një nga ekspertët, që janë këtu, tha se pas 6 muajsh mund të futen në punë. Sa kohë i duhet një invalidi për t'u futur në punë? Kush ua paguan atyre atë kohë të humbur? Ku do të punojnë ata? Ku do të ushqehen ata gjatë kësaj kohe? A e dini sa kohë i duhet një invalidi për të marrë KEMP-in? I duhet rreth një vit, sepse hasin në burokracira të tilla, si: nuk ka qenë konsulenti, nuk ka qenë njëri apo nuk ka qenë tjetri. Megjithatë, unë përsëri ju kërkoj ndjesë për tonin e zërit, por, po të jesh i sëmurë, të jesh përfitues dhe të jesh përfaqësues kanë shumë të përbashkëta.

Ne kemi bërë një propozim, që duhej t'u kishte rënë ndër mend qeverisë dhe të gjithë deputetëve. Të dashur deputetë, këto ditë, siç është parashikuar në nenin 25, do të ngrihet një fond social, ku disa shoqata joqeveritare do t'u vijnë në ndihmë invalidëve. Në përvojën time Çekia, sot për sot, ka ligjet më të përparuara për çështjet sociale, ka pasur edhe një fond për emergjencat sociale, e cila funksionon nga viti 2004 deri në vitin 2013. Dikush mund të thotë se fondet e emergjencave sociale janë të gjitha nul, sepse ato trajtohen nga bashkia, por bashkia sot është, nesër mund të mos jetë. Unë mendoj se duhet të jetë një fond social për çështjet e emergjencës, siç mund t'i keni parë në televizor. Pse të mos e ketë shteti ynë këtë gjë, sepse është garanti kryesor kushtetues i punonjësve...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Zonja Merita, nuk bëhet fjalë për një fond social për punësimin, por për një fond social për ndihmën emergjente. Për shembull, nëse Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale do të ketë një fond mujor 1 milion lekë, le të fusë 20 mijë lekë për fondin social, në mënyrë që t'u gjenden personave të varfër qoftë nga ana shëndetësore, qoftë për ndonjë problem në banesë. Megjithatë, kjo mbetet për t'u parë.

Faleminderit dhe ju kërkoj ndjesë nëse ju kam mërzhitur!

Enver Roshi – Ne të gjithë këtu jemi kolegë dhe çdo gjë tjetër është korrekte.

Unë besoj se këto propozime, që ju bëni këtu, do të merren parasysh nga Ministria e Shëndetësisë...

Abdulla Omuri – Zoti kryetar, mua më mungon një pjesë e trupit. Më mungon këmba, ndoshta për këtë nervozohem.

Enver Roshi - Ndoshta ky ligj ka kufizimet e tij dhe nuk mund të zgjidhë gjithçka, por besoj se do të merret parasysh kjo pjesë që është në përbërje të ligjit.

Zonja Merita, fjala është për ju.

Merita Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Omuri, natyrisht, e ngriti pak tonin e zërit, por ne po përpiqemi të rregullojmë defektet e mbartura nga e gjithë koha dhe të gjejmë ekuilibra ndërmjet trajtimit dhe mbështetjes për të gjithë personat që përfaqësojnë grupime të ndryshme vulnerabël. Ne do t'i trajtojmë dhe do t'i shqyrtojmë së bashku, kur ta shqyrtojmë ligjin nen për nen dhe më pas do të shprehemi me shkrim, por edhe verbalisht.

Në lidhje me krijimin e fondit social, duke dashur të trajtojmë të gjitha problematikat, bëhen edhe interferime në ligje të ndryshme. Lidhur me fondin social, që përmendi zoti Omuri, për qëllime emergjence, natyrisht i takon ligjit të emergjencave civile. Fondi social për shërbime sociale është i spongritur si mekanizëm financiar në zbatim të ligjit "Për shërbimet

shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Subjektet, që aplikojnë për të përfituar nga ky fond social, nga buxheti i shtetit, janë njësitë e qeverisjes vendore, konform projekteve të caktuara që mund t’i ketë me organizatat së bashku për ngritjen e modeleve të shërbimeve të reja në ato bashki, në të cilat mungojnë. Kështu që do të krijohet edhe një fond tjetër social në zbatim të ligjit për strehimin social, i cili është i parashikuar në atë ligj. Krijimi i tri mekanizmave sociale me emrin “fondi social” nuk bën sens dhe ndoshta ka nevojë për t’u diskutuar në një moment tjetër për pjesën tjetër të legjislacionit për emergjencat civile.

Faleminderit!

Enver Roshi – Atëherë, fjalën po ia kaloj përfaqësueseve të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, zonjave Rovenë Vuksani dhe Iva Plaushku.

Rovena Vuksani – Unë jam Rovena Vuksani nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Si fillim, ju falënderoj për mikëpritjen!

Ne kemi bërë disa komente për sa i përket pjesës së parë të ligjit, i cili ka nevojë për një rishikim nga ana e teknikës legjislative, sepse ka shumë mangësi. Komentet jua kemi depozituar me shkrim, kështu që unë po ndalem vetëm te çështja thelbësore e përmbajtjes.

Nga analiza e nenit 11, ku parashikohen subjektet përfituese, janë përjashtuar nga përftimi i asistencës sociale personat që kanë marrë nga gjykata një vendim të formës së prerë ose një vendim për masë mjekësore, siç është “mjekimi i detyruar” për personat që ndodhen në burg.

Vlerësojmë se jo të gjitha subjektet, që parashikohen si jopërfituese, duhet të përjashtohen. Konkretisht: vlerësojmë që nga ky nen duhet të hiqen personat, që përfitojnë pagesën për aftësi të kufizuar, sepse nga eksperiencia, që kemi me burgjet, kemi parë se praktika nuk është e unifikuar, pra disa e përfitojnë KEMP-in, kurse disa të tjerë nuk e përfitojnë për shkak të këtij vakuumi ligjor që është krijuar.

Gjithashtu, në nenin 16, i cili lidhet me aplikimin për përfitimin e ndihmës ekonomike, aplikimi kushtëzohet nga prania e bashkëshortëve. Vlerësojmë se kjo gjë duhet të hiqet dhe aplikimin mund ta bëjë kryefamiljari ose çdo person madhor i familjes, pa u kushtëzuar nga prania e bashkëshortëve.

Në vijim të nenit 17 parashikohet një afat prej 3 muajsh, gjë e cila ndikon në ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar. Ne sugjerojmë që ky afat duhet të zgjatet nga 6 muaj deri në 1 vit, duke marrë parasysh edhe lëvizjet e shqiptarëve jo vetëm në vendet e BE-së, por edhe në vende të tjera, si Mbretëria e Bashkuar apo SHBA-të, ku mund të qëndrojnë më shumë se 3 muaj.

Në nenin 28, në pikën 2, parashikohet edhe dëmshpërblimi në rast të shkaktimit të dëmit. Në nenin 28 dëmshpërblimi është në diskrecion të institucionit epror. Vlerësojmë që kërkesën për dëmshpërblim dhe përcaktimin e dëmshpërblimit duhet ta bëjnë gjykatat dhe jo institucioni epror, konform parashikimeve të Kodit Civil.

Gjithashtu, sa u takon afateve të anikimit, kemi propozuar disa afate në përputhje me Kodin Civil dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ne do të donim, edhe në sqarim të faktit nëse ankimi në strukturën rajonale të shërbimit social shtetëror do të konsiderohet si hallka e fundi për ankimim, që më pas personat t'i drejtoreshin gjykatës apo institucionit qendror të shërbimit social shëndetësor, i cili duhej të ishte hallka e fundit.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit!

Fjala për ju, zonja Merita.

Merita Xhafaj – Në fakt, janë disa problematika apo rekomandime të listuara në përputhshmëri me teknikën legjislative. Më duhet që t'i shikoj me juristët, në mënyrë që të jap një përgjigje konstante.

Lidhur me sanksionet, nuk mendoj se ato duhet t'i lihen vetëm gjykatës, sepse vendosja e sanksioneve nga strukturat, të cilat monitorojnë zbatimin e këtij ligji, sikurse është Shërbimi Social Shtetëror, janë pikërisht në favor të zbatimit të ligjit dhe në favor të përfituesve. Në qoftë se ne do t'i lemë të gjitha, sanksionet, bazuar edhe në vendimet e gjykatave, kjo do të thotë se ne nuk kemi asnjë lloj mjeti në dorë për të monitoruar si struktura shtetërore pushtetin vendor, ashtu edhe administratorët e punësuar në bashki, me qëllim që të zbatojmë konform legjislacionit në fuqi të gjithë skemën e dhënies së ndihmës ekonomike. Kështu që, në këtë kontekst, nuk jam dakord me faktin që kjo gjë duhet bërë me vendim gjykate.

Lidhur me pjesën tjetër, natyrisht që do ta diskutojmë me Drejtorinë Juridike dhe do t'ju kthejmë përgjigje.

Enver Roshi – Faleminderit!

UNICEF-i i ka depozituar të gjitha sugjerimet, kështu që po ua kaloj fjalën përfaqësuesve të Avokatit të Popullit, zonjave Moza Morina dhe Matilda Tyli.

Matilda Tyli – Përshëndetje, i nderuar kryetar!

Përshëndetje të nderuar anëtarë, përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe shoqërisë civile!

E vlerësoj dhe e falënderoj Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku unë kam qenë pjesë e saj për kontributin e dhënë. Ky projektligj sjell shumë risi, sidomos për sa i përket shpërblimit për bebet e porsalindura. Duke qenë pjesë e seksionit për mbrojtjen dhe

promovimin e të drejtave të fëmijëve jam munduar që projektligjin ta shikoj në parimin e interesit më të lartë të fëmijës, gjë që nuk gjen zbatim për vetë faktin, sepse ne themi që përfituese të ndihmës ekonomike janë familjet, por familja përbëhet nga bashkëshortët dhe fëmijët. Kështu që ne shpeshherë i përjashtojmë anëtarët adultë, kur ata janë të papërgjegjshëm, por kjo nuk do të thotë që ne duhet të penalizojmë fëmijët. Pra, ne mund t'i përjashtojmë anëtarët, por ndihma ekonomike duhet të jepet për fëmijët.

Së dyti, ne donim të sillnim në vëmendjen tuaj parimin e decentralizimit, i cili në projektligjin e ardhur nga ministria ishte i parashikuar, kurse tashmë nuk është i parashikuar. Ne e vlerësojmë faktin që është hequr, por propozimi konkret i institucionit të Avokatit të Popullit ishte që të riformulohej dhe të gjente zbatim, ashtu siç është në përmbajtje të ligjit.

Në vetvete parimi i decentralizimit nuk gjen zbatim, ashtu siç në të vërtetë është parimi i decentralizimit, por ajo mund të riformulohet dhe mund të gjejë zbatim sipas përmbajtjes së legjislacionit, sepse ne kemi organe në nivel vendor, të cilat kanë detyra dhe përgjegjësi për zbatimin e këtij ligji, por, në të njëjtën kohë, vendimmarrja merret nga drejtoritë rajonale. Pra, në njëfarë mënyre kjo nuk duhej të hiqej, por duhej bërë një përkufizim, i cili të gjente zbatim në përmbajtje të të gjitha dispozitave ligjore të parashikuara.

Gjithashtu, u qëndrojmë edhe sugjerimeve të Fondacionit Shqiptar për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar. Kolegia ime mund t'i shtjellojë, por meqenëse këto, për të respektuar edhe afatet kohore, u ezauruan nga shoqëria civile, edhe ne i kemi parashtruar këto sugjerime, mund të them se u qëndrojmë atyre. Pra, personat me aftësi të kufizuar demotivohen në momentin, kur ne i fusim në punë dhe u heqim pagesën e aftësisë së kufizuar. Për më tepër, ajo ka të bëjë me sigurinë juridike dhe konventën që keni ratifikuar për personat me aftësi të kufizuar: është një e drejtë e fituar dhe sigurinë juridike ne nuk mund ta heqim dot. Pra, në njëfarë mënyre, pagesën për aftësinë e kufizuar e marrin si rezultat i aftësisë së kufizuar që ata kanë.

Ndërsa disa problematika të tjera, të cilat unë do t'i sjell në vëmendjen tuaj, vijnë nga praktikatat që ne si institucioni i Avokatit të Popullit kemi.

Kemi pasur goxha problematika ose ankesa nga familjarë, të cilët kanë qenë të përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike, për vetë faktin se nuk kanë qenë të përfshira si familje aplikuese në skemën e ndihmës ekonomike.

Ministria nuk e ka vlerësuar sugjerimin tonë, pra nuk ia heq këtë të drejtë këshillit bashkiak, duke thënë: të jetë patjetër familje aplikuese. Po flasim për familje, për të cilat nga vetë drejtoritë rajonale dhe bashkitë na ka ardhur vlerësimi që janë familje në vështirësi social-ekonomike. Pra, janë penalizuar, sepse nuk kanë qenë familje aplikuese. Dashje, pa dashje, kjo

lidhet edhe me parimin e decentralizimit dhe të autonomisë vendore që duhet të ketë bashkia, ku të paktën të ketë një lloj të drejte për sa i përket marrjes së vendimeve për përfshirjen e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike ka qenë apo jo aplikuese, kjo për vetë faktin se jo të gjitha bashkitë kanë të ardhura për të mbështetur familje në vështirësi social-ekonomike.

Në këtë kontekst, mendojmë që kjo t'i lihet si e drejtë këshillit bashkiak, për familjet që nuk janë aplikuese në skemën e ndihmës ekonomike, mund të ketë të drejtën për të marrë vendime për të vendosur mbi familjet, të cilat janë vërtet në nevojë për t'u përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike.

Gjithashtu, ne e vlerësojmë shumë këtë ligj, sepse ka ardhur në momentin e duhur kur janë harmonizuar edhe shumë kuadre të tjera ligjore, siç janë Urdhri i Mjekut, i Psikologut, i Punonjësit Social, i Infermierit e të tjera.

Dihet se familja shqiptare është një familje e lidhur, pra dashje, pa dashje ne nuk kemi arritur ende në momentin që, pavarësisht se mund t'i kemi fëmijët studentë, të shkëputen nga bërthama e familjes, ata janë pjesë e një familjeje. Ndonjëherë, kur ata aplikojnë ose punësohen për shkaqe, si, për shembull, për të fituar licencën e mësuesisë, e infermierisë e të tjerë, dalin me të ardhura në sigurimet shoqërore dhe dashje, pa dashje, e gjithë familja penalizohet pse ky fëmijë vazhdon të jetë ende në arsimin e lartë. Pavarësisht se mund të ketë mbaruar *bachelor-in*, masterin, ai e vazhdon arsimin, sepse punësohet për shkak të detyrimit që ka për t'u licencuar. Në këtë kontekst, ne mendojmë që duhet të përjashtohen të gjitha ato familje ose të gjithë ata anëtarë, të cilët vazhdojnë shkollimin dhe u lind e drejta për t'u licencuar; duhet patjetër që të punësohen dhe të dalin me kontribute, pra që paguajnë sigurime shoqërore.

Një problematikë tjetër dhe tejet e rënduar, që ne e kemi hasur, madje mund të themi se kemi një numër shumë të lartë ankesash në institucionin e Avokatit të Popullit, të cilat po i trajtojmë, ka të bëjë me ndihmësit personalë të fëmijëve me aftësi të kufizuar ose fëmijëve autikë. Shpeshherë nënat janë të detyruara të qëndrojnë gjatë gjithë kohës me fëmijët dhe dashje, pa dashje, atyre u njihet vjetërsia e punës, por nuk ka kontribute për to. Në këtë mënyrë, ky ligj duhet të parashikojë derdhjen e kontributeve për këto nëna, sepse në këtë mënyrë ne realizojmë përjashtimin social dhe jo integrimin social, dashje, pa dashje, duke e ditur se çfarë do të thotë të kesh një fëmijë me aftësi të kufizuar në shtëpi. Absolutisht, ministria na ka kthyer një përgjigje që kjo gjë do të rregullohet me aktet nënligjore. Ne e pamë, por nuk e dimë se cili është neni ku do të përfshihet pikërisht kontributi që duhet dhënë për nënat, të cilat duhet të përfitojnë sigurime shoqërore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit shumë!

E vlerësoj marrjen parasysh të sugjerimeve tona, njëkohësisht dua të falënderoj edhe ministrinë për të gjitha sugjerimet që i ka reflektuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit juve!

Faktikisht, kishim ftuar sot edhe dy shoqatat e bashkive, që janë në Shqipëri, sepse, gjithnjë, në vend që të kishim vetëm një shoqatë, kemi dy.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi ftuar edhe këshillat bashkiakë të tyre për të ardhur dhe për të folur këtu në seancë dëgjimore, por asnjëra nga shoqatat nuk ka sjellë një përfaqësues të tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ndoshta.

Fjala është për ju, zonja Merita.

Merita Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne i vlerësojmë të gjitha komentet, por kam vetëm një gjë që dua t’ua kujtoj me shumë respekt të gjithë pjesëtarëve. Kur flasim, për shembull, për parimin e decentralizimit, duhet të themi se e ka hequr vetë Avokati i Popullit (e ka sjellë komentin të shkruar dhe me firmë).

Tani, në qoftë se ne flasim këtu ndryshe nga ajo që shkruajmë dhe dërgojmë, unë me Matildën jam shumë dakord, për shkak se është profesioniste e fushës, si dhe me të gjithë të tjerët, por do t’ju lutesha shumë që këtu të pasqyrojmë ato gjëra, të cilat ia vlen t’i pasqyrojmë dhe ne t’i marrim në konsideratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse edhe nga Fondacioni për Personat me Aftësi të Kufizuar përfaqësuesi, që ka qenë eksperti që ka punuar me këtë ligj, ka qenë nga ai fondacion. Sot ngrihen dhe vijnë tre veta këtu për të kundërshtuar atë që na e kanë sjellë vetë ekspertët e këtij fondacioni. Po kështu, edhe nga zoti Omuri, sinqerisht ne kemi nevojë të dimë gjërat esenciale që duhet të rregullojmë, në mënyrë që të hedhim një hap progresiv. Ky projektligj është konsultuar me të gjithë dhe të mos harrojmë që për aftësinë e kufizuar ka një dokument politikash të aftësisë së kufizuar, që është miratuar dhe e ka në detaje vlerësimin bio-psiko-social.

Nga ana tjetër, për sa i përket nxitjes së punësimit, kjo çështje është diskutuar edhe në ligjin “Për nxitjen e punësimit” që ka kaluar në këtë komision parlamentar, edhe në ligjin “Për punësimin”. Po kështu ka incentiva, të cilat e mbështesin, por, nga ana tjetër, edhe në ligjin “Për financat vendore” ka incentiva, për të cilat kanë përgjegjësi vetë komunitetet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pjesa e invalidëve të punës, si kategori, i ka kaluar totalisht Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në këtë ligj ne kemi lënë një hapësirë që të trajtohet si kategori në nevojë, por vendimi do të merret pastaj në funksion të... Ka një vendim për fushën e mbulimit të çdo ministrie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, të trajtojmë ato problematika që mbulon Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ligji “Për asistencën sociale” ka të bëjë me pagesat në kesh, që janë të ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të bebeve të sapolindura. Të gjitha problemet e tjera rregullohen me ligje të tjera.

Enver Roshi – Zonja Merita, më falni që po ju ndërpres!

Merita Xhafaj – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Në qoftë se është e mundur, nga e gjithë fjala e përfaqësuesve të Avokatit të Popullit, fiksova atë të fundit fare, kujdesin ndaj nënave të fëmijëve autikë, për ndihmën ndaj tyre. A përfshihet kjo?

Merita Xhafaj – Pjesa e ndihmës personal...

Është pikërisht kjo arsyeja pse edhe te ndihma ekonomike, edhe te masa e aftësisë së kufizuar, nuk është lënë më një tavan. Kjo për shkak se ne e konsiderojmë, sikurse e përmendi dhe e sqaroi ministria, që masa dhe mënyra e përfitimit do të rregullohen me akte nënligjore. Periudha e tranzicionit është parashikuar gjashtë muaj dhe pas kësaj periudhe, natyrisht, shtrihet edhe skema e reformës së aftësisë së kufizuar, ku ndihmësi personal është njëra nga strukturat që është pjesë e reformës, por paralelisht janë edhe aktet nënligjore që do t’i shikojmë për ta marrë në konsideratë këtë kërkesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Ines Leskaj, përfaqësuese e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas. Ju lutem, fokusoheni sa më shumë në drejtim të ligjit.

Ines Leskaj – Jo, komentet i kam të shkurtra.

Unë jam Ines Leskaj, përfaqësuese e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas, i cili përbëhet nga dhjetë organizata dhe pikërisht kontributet, opinionet ose komentet na kanë ardhur edhe nga organizatat që ofrojnë shërbime.

Duke qenë se i kemi dërguar edhe me shkrim, po paraqes shkurtimisht disa nga komentet ose opinionet tona.

Kemi parë nenin 7 të ligjit, për të cilin është sugjeruar nga organizatat që të shtohen si përfituese të ndihmës ekonomike edhe gratë (pra në kategoritë e listuara aty) që janë në proces divorci ose zgjidhje martese dhe që gjatë kësaj kohe kujdesen për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Kjo kategori nuk është e përfshirë. Shumë nga këto gra ndodhen në kushte të atilla që mund të kenë nevojë të përfitojnë ndihmën ekonomike deri në marrjen e vendimit nga gjykata për caktimin e detyrimit ushqimor, që i takon ta paguajë ish-bashkëshorti dhe fillimin e ekzekutimit të këtij vendimi.

Gjithashtu, në pikën 7 të nenit 12 ne mendojmë të rishikohet ose të ritrajtohet kjo pikë. Aty thuhet që anëtarit të familjes në nevojë, me vendim gjykate të formës së prerë, që vuan dënimin me heqje lirie e të tjera, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen. Ne mendojmë që kjo duhet rishikuar, pasi është diskriminim, pse jo, ndoshta edhe shkelje e të drejtave për fëmijët dhe për anëtarët e familjes.

Referuar germës “e” të pikës 1 të nenit 15, mendojmë se është shprehur në mënyrë të paqartë pjesa e dytë e paragrafit. Është një pikë e rëndësishme dhe duhet të shprehet qartësisht, në mënyrë që të mos lërë vend për keqinterpretim.

Në qoftë se doni dhe keni kohë ta lexojmë nenin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, e kemi dërguar, por mund ta sjellim edhe me komente më të qarta.

Gjithashtu, referuar germës “ç” të pikës 2 të nenit 15, mendojmë se ka nevojë përsëri për qartësim se si përfituesit rezultojnë me të ardhura dhe kushte shumë të mira. Për shembull, ato familje, të cilat nga inspektimi që administratorët shoqërorë kryejnë në banesë, thuhet: “rezulton se jetojnë në kushte të mira”. Cilat janë kriteret, kushtet shumë të mira, se ndonjëherë, nëse nuk përcaktohen, i lihet vend edhe interpretimit të administratorëve se cili është kushti shumë i mirë?

Sugjerojmë, gjithashtu, të përfshihen si përfitues të asistencës sociale gratë e divorcuara, siç e përmendëm, me fëmijë në ngarkim, në rastet specifike kur bashkëshorti nuk pranon të paguajë detyrimin, sepse gjenden në mes të katër rrugëve edhe gratë, edhe fëmijët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka raste kur vërtetohet që ish-bashkëshorti nuk ka mundësi punësimi, është pa të ardhura e të tjera.

Një sugjerim tjetër është që të citohet shprehimisht dhe qartësisht në ligj se ndihma që përfiton një viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare, që ka urdhër mbrojtjeje, të mos ketë lidhje me përfitimet e tjera të ndihmës ekonomike, në kuptimin që përfitimi nga urdhri i

mbrojtjes të jetë i lidhur vetëm me statusin si viktimë e dhunës dhe gjatë kohës që ajo e ka këtë status.

Gjithashtu, sugjerojmë që në ligj të parashikohet që përfitimi i ndihmës për urdhër mbrojtjeje të fillojë të lëshohet që në datën e lëshimit të urdhrit të mbrojtjes, sepse vonesat në aplikime, për shkak të kushteve ku ndodhet viktimja, ndonjëherë e lënë edhe me muaj të tërë pa këtë pagesë, për shkak të procedurave që zgjasin. Po ashtu, aty përcaktohet se ato viktimja ose ata njerëz, që përfitojnë strehim, për shembull, në strehëzën kombëtare apo edhe në institucione rezidenciale, nuk e përfitojnë ndihmën ekonomike. Duhet ta kuptojmë që këto gra dhe vajza në shumicën e rasteve janë pa asnjëlloj të ardhure, pa asnjëlloj përfitimi, pa asnjëlloj ndihme ekonomike. Kështu që ky përjashtim nuk na duket i drejtë.

Kemi një koment të përgjithshëm, që, ndoshta, mbetet për t'u parë dhe për t'u monitoruar se sa do të jetë masa e ndihmës ekonomike, por kjo mbetet për t'u parë në momentin kur të përgatitet VKM-ja, pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Këto kishim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund t'i dërgojmë sërish edhe më të qarta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Fjala është për ju, zonja Merita, por, ju lutem, shkurtimisht!

Merita Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Këtu bëhet fjalë për nenin 7 thatë ju. Përgjigjen e rekomandimit që dhatë e gjeni në nenin 16 “Aplikimi dhe përfitimi i ndihmës ekonomike”. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet në germën “b” ku thuhet: “Secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë”. Kjo do të thotë që është parashikuar.

Lidhur me komentin e përfitueseve gra, viktimja të dhunës në marrëdhëniet familjare, ato ndodhen brenda qendrave rezidenciale dhe marrin 3 mijë lekë në muaj kesh, përveç strehimit, ushqimit dhe riintegrit, gjetjes së punës e të tjerë. Lidhur me urdhrin e mbrojtjes, ku ju thoni që duhet t'u jepet mundësi dhe fuqi, ai ekzekutohet automatikisht dhe nuk kanë nevojë të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike, sepse urdhri i mbrojtjes i kalon direkt bashkisë, e cila është e detyruar të bëjë pagesën menjëherë sa i shkon urdhri i mbrojtjes. Prandaj ne kemi vënë sanksione brenda, që ju kërkon t'i kalojnë gjykatës, që t'i vihen administratorit shoqëror që nuk e ezauron dhe nuk e ekzekuton këtë urdhër.

Faleminderit!

Enver Roshi - Fjalën e kanë përfaqësuesit e komunitetit egjiptian dhe rom, të cilët kanë sjellë rekomandimet e tyre dhe i kemi të printuara, por nëse kanë diçka tjetër, mund të na e thonë.

Franc Terihati - Unë quhem Franc Tehirati, jam përfaqësues i komunitetit egjiptian dhe rom.

Komenti ynë lidhet me përfshirjen e një kategorie të caktuar subjektsh të nenit 8 i ligjit. Ne fillimisht i kemi referuar ligjit nr. 7703, ligjit për sigurimet shoqërore, i cili në pikën 35 parashikon dy kritere për të përfutur pensionin e invaliditetit, ku duhet plotësuar kuota minimale e sigurimit dhe ekzistenca e së paku 12 muajve sigurime shoqërore në 5 vjetët e fundit. Shumë shpesh ndodh që subjekte të caktuara nuk i plotësojnë këto dy kritere ose njërin nga këto të dy dhe e kanë të pamundur të kualifikohen dhe të jenë përfitues në bazë të ligjit nr.9355, i cili shfuqizohet nga ligji i ri, që ne po diskutojmë. Ne mendojmë se duhet të përcaktojmë shprehimisht në ligj që të gjitha subjektet, të cilat përjashtohen si përfitues nga ligji për sigurimet shoqërore, të përcaktohen si përfitues në bazë të nenit 8 të ligjit që po diskutojmë sot. Ky është qëndrimi ynë, sepse në kushtet që ne kemi sot krijohet një pabarazi e qartë, pasi nga njëra anë kemi persona me aftësi të kufizuara, të cilët deklarohen të paaftë për punë dhe përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar, nga ana tjetër kemi persona të tjerë, që kanë kontribuar të skema e sigurimeve shoqërore dhe nuk plotësojnë kushtet e nenit 35 dhe përjashtohen, sepse kuadri ligjor në fuqi parashikon që, edhe në qoftë se kanë një vit sigurime shoqërore, nuk mund të jenë pjesë e kësaj skeme. Prandaj, ne vlerësojmë që është e domosdoshme të vendoset në ligj dhe të mos jetë më e drejtë e Këshillit të Ministrave të përcaktojë një gjë të tillë, sepse deri sot kemi qenë para një situatë, ku dikush që ka investuar 2, 5 apo 10 vjet në skemën e sigurimeve shoqërore, nuk përfiton as nga ligji i sigurimeve shoqërore dhe as nga ligji për asistencën sociale, që është sot.

Fatjona Caka – Përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Fatjona Caka, anëtare e minoritetit egjiptian. Në fakt, për të theksuar sesi ka lindur ky problem, ne e kemi evidentuar nga puna jonë në terren me minoritetet rome dhe egjiptiane, ku pas ndryshimeve të vitit 2014 shumë familje rome dhe egjiptiane nuk kualifikohen në asnjë nga skemat e sigurimeve shoqërore, edhe nëse kanë kontribuar në sistemin e sigurimeve shoqërore. Kjo ka ardhur për shkak se ndryshimet e sjella kanë rritur periudhën minimale të sigurimit, por kanë shtuar edhe një kriter të ri, që është 12 muaj sigurime gjatë 5 vjetëve të fundit. Bazuar në një shkresë, ku ne kemi kërkuar informacion, numri i aplikantëve të refuzuar për shkak të këtij ligji është 1913 për periudhën 2015-2017 dhe 400 aplikime në vitin 2018. Pra, një total prej 2313 individësh, të cilët mbeten jashtë çdo skeme, si

nga ajo e shërbimit social, ashtu edhe nga ajo e sigurimeve shoqërore. Ne jemi në kushtet kur shteti shqiptar ofron ndihmë për personat që nuk kanë kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore dhe kanë lënë pa mbështetje individë, të cilët kanë kontribuar, janë të paaftë objektivisht, por nuk përmbushin këtë kriter.

Në frymën e këtij ligji që po diskutohet, ne e shohim të rëndësishme përfshirjen e kësaj kategorie, e cila mund të jetë si masë tranzitore e përkohshme deri në një zgjidhje efektive.

Merita Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky, në fakt, është një problem dhe përfaqësuesit kanë shumë të drejtë. Ky nuk është problem vetëm për komunitetin rom dhe egjiptian, por është për të gjithë, sepse ligji për sigurimet shoqërore parashikon sigurime për 12 muaj në 5 vjetët e fundit, gjë që ka penalizuar edhe invalidët e punës, por mënyra si kërkohet apo rekomandohet nuk është zgjidhje, sepse ne kemi kategori të ndryshme, të cilat përfitojnë edhe nga skema e sigurimeve shoqërore, edhe nga asistenca sociale, që do të thotë se për arsye dhe kategori të ndryshme ka një pagesë nga sigurimet shoqërore dhe një pagesë nga pjesa e shërbimit social shtetëror. Kjo duhet të zgjidhet, është lënë edhe detyrë nga zëvendëskryeministri për sigurimet shoqërore dhe shërbimin sociale shtetëror, madje janë lënë edhe afate, sepse ka një faturë financiare dhe, sigurisht, ka nevojë për ndryshimin e ligjit të sigurimeve shoqërore. Në ligjin e sigurimeve shoqërore duhet të bëhet një parashikim i ndryshëm nga ai që është aktualisht, ku duhet të kenë 12 muaj në 5 vjetët e fundit. Grupi i punës ka filluar të punojë për këtë.

Faleminderit!

Franc Terihati – Unë mendoj se kjo çështje duhet të zgjidhet me ligjin aktual që ne po diskutojmë, sepse, sido që të vendoset parashikimi ligjor të ligji për sigurimet shoqërore, pra edhe nëse hiqet periudha 12 muaj sigurime, sërish është periudha minimale që duhet plotësuar. Pra, në çdo rast do të kemi një kriter të caktuar, dhe me të drejtë, që për të përfituar nga sigurimet shoqërore, qoftë edhe një pagesë më të konsiderueshme, duhet të kemi disa kriterë të caktuara që duhen plotësuar. Nga ana tjetër, mosplotësimin e atyre kriterëve apo përmirësimi i këtyre kriterëve sërish do t'i linte këto subjekte pa përfituar një pagesë, ndërkohë që subjekte të tjera, të paafta për punë, e përfitojnë pa pasur asnjë vit sigurime shoqërore dhe të tjerët, pavarësisht se mund t'u përmirësohet pozita pas një rregullimi ligjor më të mirë të ligjit të sigurimeve shoqërore, përsëri do të ngelnin pa përfituar, prandaj ky rregullim duhet të vendoset këtu.

Fatjona Caka- E mora fjalën përsëri thjesht për ta theksuar rëndësinë e problemit. Konkretisht në nenin 8 të këtij projektligji parashikohen subjektet përfituese dhe rekomandimi im konkret është që si subjekt në përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar, në kuptim të këtij

ligji, të përfshihen edhe personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Aftësisë së Kufizuar, të cilët me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore përjashtohen si pasojë e zbatimit të kriterëve që lidhen me kohëzgjatjen e kontributeve në skemën e sigurimeve shoqërore të aplikantëve. Duke qenë se nga viti 2014 këta individë kanë qenë të pambështetur dhe jashtë çdo skeme, të cilët duhen mbështetur për shkak të gjendjes shëndetësore dhe jo thelbi të jetë në kontributet e tyre, le të jetë kjo një masë tranzitore që të mbështesë fillimisht familjet, duke qenë se ne kemi kohë që advokojmë edhe ndryshimin e ligjit nr. 7703 për sigurimet shoqërore, dhe të jetë një siguri për të gjithë individët që ne përfaqësojmë dhe ndodhen në këto kushte, ku realisht u shkelen shumë të drejta, sepse, edhe pse janë në gjendje shëndetësore të rëndë, ata janë të përjashtuar nga shumë përfitime, sepse statusi nuk lidhet vetëm me mbështetjen financiare, por edhe me shumë përfitime të tjera dhe, nëse gjatë rrugës mund të zgjidhet problemi edhe më afatgjatë, absolutisht që do të jemi dakord. Këtë moment e shohim si shumë të rëndësishëm për të mbështetur këta individë.

Klodiana Spahiu – A mund të ndërhyj vetëm një moment, sepse ky është një problem i mbartur dhe i trashëguar?

Të gjithë përfaqësuesve që janë këtu ne u premtojmë që brenda një periudhe shumë të shkurtër kjo do të zgjidhet, sepse për këtë problem ka një dakordësi nga i gjithë grupi parlamentar socialist. Unë sapo kontaktova me kryetarin e grupit dhe kjo do të marrë zgjidhje, besoj në formën më të mirë, sepse është i njëjti propozim që bëri edhe kryetari i komisionit. Kjo është rruga e vetme dhe më e drejta për t'u zgjidhur kjo çështje. Kështu që, të lutem Merita, po ju drejtohem juve, e kemi shumë të domosdoshme këtë gjë! Përfundimisht kjo gjë nuk zgjidhet nga sigurimet shoqërore, sepse ne kemi marrë disa konfirmime nga drejtori i sigurimeve që aty nuk bëhet. Kështu që kjo, të paktën për një periudhë të caktuar, duhet të zgjidhet në nenin 8. Nuk besoj se sigurimet shoqërore do të prishin skemën për të zgjidhur një gjë të tillë. Kjo nuk është vetëm për personat me aftësi të kufizuar. Numri nuk është shumë i madh. Nga ne e keni mbështetjen, por pritet vendimi që do të marrë ministria.

Merita Xhafaj – Unë e thashë edhe në fillim që ky është një problem, të cilin e kemi diskutuar shumë herë këtu, por mendoj se në këtë mbledhje ndoshta duhet të ishin edhe përfaqësuesit e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, sepse në atë ligj është e shkruar: “12 muaj në 5 vjetët e fundit” dhe, në qoftë se e fusim në këtë ligj, nuk është ky ai që shfuqizon një nen të ligjit tjetër.

Së dyti, ky lloj ligj nuk kufizon, përkundrazi, në nenin 8, germa “ç” (se vetëm germa “ç” është shtuar këtu, kurse nenet e tjera janë ato që kanë qenë, e cila nuk është e përjashton)

jep mundësi që me vendim të Këshillit të Ministrave, në ndryshim nga ligji për sigurimet shoqërore që e ka në ligj, nëse vendoset që të shfuqizohet ai nen i atij ligji dhe të kalojë këtë, të kalojë me gjithë buxhetin, sepse fatura buxhetore për këtë qëllim nuk është e vogël. Fatura e buxhetore u është dhënë sigurimeve shoqërore. Edhe në buxhetin afatmesëm 2020-2022 është e parashikuar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore jo në këtë ministri. Pra, këtu është lënë një hapësirë që do të bëhet më pas me vendim, nëse gjykohet që do t'i kalojë Shërbimit Social Shtetëror, por, aktualisht, skema e kontributeve është e gjitha tek Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Afati është te neni respektiv i ligjit për sigurimet shoqërore.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu - Merita, edhe nëse ne e realizojmë tryezën përpara se të miratohet ligji, unë kam merak vetëm një gjë, Pasi të miratohet kjo, do të shikojmë se do të ketë një shtim të numrit të invalidëve, sepse gjithmonë kështu ka ndodhur. Në duhet t'i ndalojmë një herë e mirë rastet abuzive dhe duhet të verifikojmë rastet kur jepet invaliditeti, që ta marrë ai që e meriton, sepse nga momenti, kur ne do ta bëjmë këtë ndryshim ligjor për të përfituar vërtet ata që janë shumë të sëmurë, dhe ne kemi 4 vjet që themi se do ta realizojmë, do të përfitojnë shumë abuzues. Kështu që nuk e di se si do ta rregullojmë këtë gjë.

Merita Xhafaj – Ne kemi regjistër elektronik, megjithatë rastet e abuzimeve nuk parandalohen. Domethënë, patëm një rast aktualisht te skema e aftësisë së kufizuar. Kemi ngritur edhe task forcë, kemi edhe regjistër elektronik, por në momentin që për shkak të deregulimit u bë me paraqitje dosjeje dhe jo me paraqitje fizike të personit, skema ka ardhur duke u rritur në ato përmasa, që i ka tejkaluar tavanet e buxhetit që kemi. E njëjta gjë, sikurse thoni ju, ka për të ndodhur edhe me pjesën e invalidëve, por kjo është një gjë tjetër, pra është pjesë e monitorimit dhe e menaxhimit të sistemit të informacionit. Kështu që, paraprakisht, në parim duhet të vendoset edhe nga pikëpamja ligjore, edhe nga pikëpamja e skemës së financimit se si do të funksionojë, në mënyrë që të gjejmë mekanizmat e monitorimit.

Fajtona Caka - Duke qenë se do të diskutohet, ideja është se ne kemi individë, që kanë kontribuar nga 27 vjet, nga 20 apo 15 vjet, të cilët, kur kanë kontribuar, kanë pasur pritshmërinë që në të ardhmen do ta marrin përfitimin e tyre, pra kur të përmbushin të gjitha kriteret, por aktualisht nuk dihet si përdoret ky buxhet apo këto para të derdhura nga këta njerëz, se ku bllokohen dhe si mund të gjendet një mënyrë për t'i ripërdorur, që ata në një mënyrë t'i përfitojnë ato që kanë humbur.

Franc Terihati – Kjo dispozitë është vërtetë e hapur, pra ia lë aktin nënligjor, por në kushtet ku jemi sot, në qoftë se do të miratohet ky ligj, duke pasur parasysh edhe aktin nënligjor që është miratuar, që do të mbetet në fuqi derisa të miratohet akti nënligjor tjetër, do të sillte

si pasojë që këto subjekte të vazhdonin të ishin të përjashtuara. Gjatë gjithë kohës që do të ishte në fuqi ky akt nënligjor, por jam i sigurt që, edhe në qoftë se do t'i lihej vullnetit të Këshillit të Ministrave, në atë linjë do të vazhdonte. Ne mendojmë se kjo çështje duhet zgjidhur në ligj dhe nuk bie fare ndesh me ligjin për sigurimet shoqërore. Prandaj, në qoftë se do të bëhet, të bëhet këtu, meqenëse është momenti.

Eneida Capo – Përshëndetje!

Jam Eneida Capo, përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në lidhje me subjektet përfituese të ligjit, në nenin 8, ku përcaktohen personat me aftësi të kufizuar, thuhet: “Personat që janë deklaruar të tillë me vendim të një komisioni”. Ligji nuk thotë personat, që nuk kanë përfituar nga skema e sigurimeve shoqërore, pra përfitues është pasi është deklaruar si i tillë nga komisioni. Kriteret për dalë në komision përcaktohen me VKM. Mjafton të mosvendosim kriteret përjashtuese dhe këta persona, që kanë periudha kontributeve, por nuk e kanë në periudhën e duhur për të përfituar nga sigurimet shoqërore, automatikisht mund të përfshihen në skemën e mbrojtjes sociale. Kështu që nuk e shikoj si diçka që duhet përfshirë në...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e them nga pikëpamja juridike, meqenëse jam juriste.

Ligji thotë: “Personat me aftësi të kufizuar të deklaruar të tillë me vendim të komisionit”. Pra, ligji nuk vë kriteret, por thotë: “Personi që është komisionuar”. Për t’u komisionar, kriteret vihen me VKM. Domethënë, të mos ketë periudha kontributeve, të mos ketë punuar. Pra, këtu duhet bërë rregullimi me akt nënligjor. Ligji nuk ka kriteret për të dalë në komision. Ne themi përfituesi i pagesës është ai, që është deklaruar me vendim KMCAP-i, por se si shkon deri në komision kriteret përcaktohen me VKM. Kështu që nuk e shikoj të arsyeshme të bëhet një përcaktim i tillë në ligj.

Fajtona Caka – Në fakt, kështu është, por dua të them se në ligjin e mëparshëm në VKM është vendosur si kriter që personat nuk duhet të kenë qenë në marrëdhënie pune më parë, pra ligji e specifikonte nëpërmjet VKM-së kufizimin që do t’u bëhej personave. Ne do të kishim një lloj sigurie nëse do të përfshihej në ligj, por, edhe nëse përfshihet në vendim, duhet rregulluar specifikisht, sepse si do të funksionojë pastaj?!

Ju po bisedonit edhe për numrin e abuzuesve. Duhet përcaktuar që personat, të cilët me vendim të komisionit të aftësisë janë objektivisht të paafte, me të gjitha procedurat dhe me të gjitha vendimet e nevojshme, dhe të jenë të refuzuar pikërisht nga ky nen, në këtë mënyrë do

ta kufizonin numrin e personave, që, realisht, duan të përfitojnë dhe që u preket kjo e drejtë që ne po themi.

Eneida Capo – Atëherë, në ligj përcaktohet se kriteret do të bëhen me VKM, kështu që nuk kemi pse vëmë kritere në ligj si për ndihmën ekonomike, ashtu edhe për aftësinë e kufizuar.

Enver Roshi – A thuhet në ligj në fund që kjo do të bëhet me VKM?

Eneida Capo – Po, në nenin përkatës.

(Diskutime pa mikrofon)

Në nenin 17 të projektligjit, pika 1, fjalia e dytë, thuhet: “Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Pra, këtu thuhet se kriteret përcaktohen me VKM. Mjafton të mos ketë kritere përcaktuese dhe nuk ka asnjë pengesë.

Franc Terihati – Në fjalën time unë nuk diskutova që neni 8 është dispozitë e hapur, por sugjerova që kjo gjë të përcaktohet në ligj. Ligji nuk ka pse të mos jetë i detajuar në këtë pikë dhe t’i përcaktojë subjektet përfituese, për më tepër që këto janë subjekte, që vijnë si pasojë e përjashtimit nga një dispozitë tjetër ligjore, që është neni 35.

Nga ana tjetër, vetë subjektet përfituese, neni 35 i ligjit për sigurimet shoqërore, përcaktohen në ligj dhe këto përjashtohen si rrjedhojë e zbatimit të një akti ligjor dhe jo të një akti nënligjor. Prandaj po synojmë që këto subjekte të vendosen në ligj.

Së dyti, duke mos u vendosur në ligj, sot e kemi aktualisht një VKM, kemi vullnetin e Këshillit të Ministrave. Kjo VKM do të vazhdojë të jetë në fuqi derisa të miratohet akti tjetër nënligjor dhe kjo VKM i përjashton këto subjekte. Unë e kuptoj se shumë gjëra mund t’i parashikojmë edhe me akte nënligjore. Pse të mos i përcaktojmë në ligj, kur vullneti i grupit parlamentar është për t’i përcaktuar në ligj dhe i jep një zgjidhje një kategorie të subjekteve, që po trajtohen në mënyrë të barabartë me subjektet e tjera, që nuk investojnë fare në skemë?

Moza Morina – Jam dakord me zotërinë që të jetë e përcaktuar në ligj, derisa të dalin aktet nënligjore, sepse ne e dimë që janë shumë akte nënligjore të tjera në zbatim të ligjit për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar, që ende nuk ka dalë. Tashmë ka kaluar mjaft kohë dhe ka ardhur koha që kjo kategori duhet të përfitojë. Ne e kemi ngritur që në vitin 2014.

(Diskutime pa mikrofon)

Derisa të dalin aktet nënligjore, unë them që të jetë e përcaktuar në ligj.

Eneida Capo – Pavarësisht faktit që mund ta përcaktojmë në ligj, dhe do kohë hartimi i akteve nënligjore, duhet të kemi parasysh që një ligj pa akte nënligjore është i pazbatueshëm. Kështu që pa diskutim që do të pritët nxjerrja e akteve nënligjore.

Së dyti, ne sot për sot e kemi zgjidhur këtë çështje me pilotimin e reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar, e cila po pilotohet në dy njësi administrative, ku është bërë tashmë përcaktimi që ka të drejtë të përfitojë çdo njeri, pavarësisht nëse është përfitues apo jo nga skema e sigurimeve shoqërore.

(Diskutime pa mikrofon)

Në dy njësitë administrative e ke të zgjidhur, është e përcaktuar me VKM. Këtë do të bëjmë: do të përmirësojmë VKM-të aktuale.

(Diskutime pa mikrofon)

Enver Roshi – A keni vështirësi nga ana juridike për t'i dhënë një qartësi ligjit, që të gjeni një indicie që ta futni diku edhe këtë kontingjent? Ai është i futur, por kam përshtypjen se në implementim ka vështirësi. Shqetësimi i deputetëve dhe i grupeve të interesit është që t'ju vijmë në ndihmë atyre.

Merita Xhafaj - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë gjykoj se disa nga kërkesat janë ligjore-juridike disa nga kërkesat janë teknike.

Për sa kohë flasim për teknikën legjislativë, mendoj që juristët e ministrisë sonë duhet të punojnë bashkë me juristët e komisionit dhe t'i trajtojnë një për një, sikurse bëhet vazhdimisht dhe kjo është procedura normale, se cilat kanë mbivendosje me ligjet e tjera, cilat nga problematikat mund të përfshihen këtu dhe çfarë mund të trajtohet me akte nënligjore. Të bëjnë një skemë të saktë, kurse ne të shikojmë pjesën e përputhjes së teknikës legjislativë.

Për sa u takon problemeve teknike të bartura prej shumë vitesh, unë jam dakord që ne të zgjidhim ato çështje që penalizojnë shumë grupime vulnerabël, sikurse është pjesa e ligjit të sigurimeve shoqërore, por nga ana tjetër ne nuk mund të marrim përsipër sot, që, nëpërmjet këtij ligji, në një periudhë gjashtë muaj deri në hartimin e akteve nënligjore, të fusim kriteret në ligj, të cilat janë në dokumentin e politikave për aftësinë e kufizuar, të cilat janë pjesë e reformës së aftësisë së kufizuar. Reforma në aftësinë kufizuar kërkon stadin e saj, pilotim dhe ka impaktet e saj, qoftë financiare, qoftë sociale.

Në këndvështrimin e ligjit për aftësinë e kufizuar, këtu janë përfshirë detyrimet e pagesave në kesh dhe mënyra e trajtimit të pagesave në kesh. Pjesa e shërbimeve është futur te ligji për shërbimet shoqërore, pjesa e aksesueshëmërisë është përfshirë te ligji i aksesueshëmërisë, pjesa e statuseve të disa kategorive të aftësisë së kufizuar është te statuset e disa kategorive.

Ky nuk mund të jetë një ligj kuadër që të përmbledhë të gjitha problematikat që janë adresuar në ligje të ndryshme. Ne nuk jemi në kundërshtim për problematikat e ngritura, por nuk trajtohen të gjitha sot me një të rënë të lapsit, sepse kanë kosto financiare.

Për hir të së vërtetës, të gjithë duhet të jemi të ndërgjegjshëm që kjo nuk është tryeza e parë që ne ulemi për të diskutuar, sepse ne jemi ulur dhjetëra herë përpara se ta çonim ligjin në qeveri dhe pastaj të vinte këtu. Kjo është dëgjesa e fundit. Ju keni dhënë komente me shkrim, të cilat janë të pasqyruara, sepse neve nuk na e miraton më Këshilli i Ministrave një projektligj pa vënë komentet e secilës organizatë dhe si është reflektuar nga ana jonë, cili merret në konsideratë dhe cili nuk merret.

Prandaj, pa dashur aspak të kundërshtoj, por duke dashur të vëmë brenda ligjit ato piketa, të cilat janë të domosdoshme të jenë pjesë e këtij ligji, unë do t'ju lutesha, duke ju falenderuar të gjithëve, organizatat e shoqërisë civile, Avokatin e Popullit dhe komisionerin, që juristët tanë të ulen të punojnë përpara se ne ta miratojmë nen për nen.

Faleminderit!

Adelina Rista – Faleminderit, kryetar!

Kam vetëm dy fjalë për çështjen e fundit.

Ju falënderoj për dëgjuesën, e cila neve na intereson, sepse sa më shumë dëgjojmë, aq më të mirë i bëjmë ligjet!

Dua të falënderoj në mënyrë të veçantë përfaqësuesit e ministrisë, Meritën, e cila na qartëson me qetësi dhe kompetencë profesionale për të gjitha problematikat që hasim!

Meqenëse (po i referohem fjalës së zonjës Merita) 12 muaj sigurim në 5 vjetët e fundit kanë krijuar kaq shumë probleme (të gjithë hasemi me këto probleme, deputetët me njerëzit poshtë që kanë ankesa), kjo çështje është sensitive dhe me të është impenjuar edhe qeveria duke ia ka caktuar detyrë Shërbimit Social dhe sigurimeve shoqërore që të merren me këtë problem. Unë mendoj të thërrasim në një seancë të veçantë përfaqësuesit e dy palëve për dëgjuesë që të na shpjegojnë deri ku kanë arritur. Besoj se do të ishte mirë të ishit prezente edhe ju, zonja Merita, për të na dhënë ndonjë mendim në formën e bashkëpunimit. Besoj se kjo do të jetë gjë e mirë për të gjithë ne.

Faleminderit!

Enver Roshi – Jam dakord me propozimin e Adelinës. Besoj se të gjithë anëtarët e komisionit janë dakord për këtë gjë. Kështu që, në një takim tjetër që do të bëjmë, do të hedhim sërish për diskutim ato pika që u shtruan këtu nga ju.

Dritan Hoxha – Faleminderit!

Zonja Merita, pak më parë, (për ndryshimin që u bë në ligjin nr. 9355), ju referuat që ADRF-ja ka paraqitur këtë ndryshim ligjor, por jo gjithçka mund të jetë perfekte, sepse në një periudhë të caktuar u pa që ky ndryshim ligjor ka cenuar personat para dhe tetraplegjikë. Si të tillë, jemi në karrige me rrota dhe nuk mund të vihet shenja e barazimit me grupet e tjera, personat që mund të ecin. Pra, ky ligj ka cenuar vetëm statusin e personave para dhe tetraplegjikë.

Kërkoj mbështetjen tuaj që ky ndryshim ligjor në pikën 2 të rishikohet dhe ndryshohet me të njëjtin vullnet që është miratuar.

Sidita Fortuzi - Faleminderit!

Për sa i përket çështjes së afateve, 48 muaj, 24 muaj, që u ndryshua në mënyrë të vazhdueshme, doja të theksoja që ne si ADRF jemi angazhuar me komunitetin për t'i bërë këto ndryshime, por në funksion të asaj që personat me aftësi të kufizuar kanë frikë se humbasin pagesat, kjo i frenon. Ose do ta lënë punën pas 2 apo 4 vjetësh.

Arsyeja pse ne kemi propozuar këto masa tranzitore është edhe procesi i reformës së vlerësimit. Prandaj, është arritur në këtë kompromis me autoritetet e ministrisë, me të cilat ne kemi pasur bashkëpunim dhe kemi gjetur gjithmonë reflektimin për ligjet që ka frikë komuniteti, por meqenëse e kemi ligjin në tavolinë, le ta zgjidhim në mënyrën më të mirë dhe të qëndrueshme.

Enver Roshi - Dua të falënderoj të gjitha grupet e interesit! Gjithashtu, falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë për përgjigjet!

Në qoftë se do të bëjmë ndonjë ndryshim apo seancë tjetër dëgjimore, do t'ju vëmë në dijeni për të gjitha gjërat. Mendimet dhe sugjerimet tuaja do të merren parasysh dhe do të diskutohen deri në prag të vendimit për hartimin e ligjit nen për nen.

Faleminderit dhe suksese!

Ditë mbarë!